

MEHMET ÇELIKU

## KUANTITETI I ZANOREVE TË THEKSUARA NË TË FOLMET E SHQIPES <sup>1</sup>

Studimi i kuantitetit të zanoreve në përgjithësi dhe i zanoreve të theksuara në veçanti paraqet sot mjaft vështirësi. Duke folur për këtë çështje E. Çabej thotë: «Në fushën e vokalizmit të shqipes kuantiteti i zanorevet të theksuara më duket të jetë dukuria më pak e studjuar gjer më sot e njëkohësisht edhe më e vështira»<sup>2</sup>.

Studimin e kuantitetit të zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes e vështirësojnë këto tri rrethana: së pari, ndërmjet dy dialekteve të shqipes, grupeve të të folmeve, ndërmjet të folmeve dhe brenda kufive të një të folmeje ekzistojnë ndryshime mjaft të mëdha të shkallëve të gjatësisë së zanoreve të theksuara në të njëjtat forma gramatikore, madje herë-herë në të njëjtin pozicion fonetik; së dyti, matja e saktë e kuantitetit të zanoreve është detyrë e fonetikës eksperimentale, që në këtë fushë mund të thotë fjalën përfundimtare; së treti, gjatësia e zanoreve të theksuara të shqipes së sotme është një përzierje e sistemit të vjetër të gjatësisë së hershme me tipin e ri të gjatësisë kompensatore etj.

Kuantitetit të zanoreve të shqipes i kanë kushtuar vemendje mjaft gjuhëtarë të huaj e vendas. Midis tyre po përmendim: Boppin (1854), Hahnin (1854), Kamardën (1864), Dozonin (1879), Pekmezin (1908), Weigandin (1913), Nahtigalin (1917), I.D. Sheperin (1927). Këta gjuhëtarë kuantitetin e zanoreve nuk e kanë trajtuar në studime apo artikuj të veçantë, por në studime e gramatika që kanë një tematikë të gjerë.

Ne nuk do ta bëjmë paraqitjen e gjendjes së studimit të kësaj teme nga autorët e mësipërm, sepse në vija të trasha kjo tashmë është bërë<sup>3</sup>. Megjithatë më poshtë, sipas rastit, do të mbajmë qëndrim për ndonjë pohim të tyre.

Vetëm më 1957 E. Çabej i kushton një studim të veçantë kuantitetit të zanoreve të theksuara, duke parë kryesisht zanoret e gjata. Autori përpiket, midis të tjerave, të argumentojë me fakte se në gjuhën e sotme shqipe ekzistojnë «gjatësitë e trashëguara nga një e kaluar e lashtë». E. Çabej beson «se për gjatësinë e për shkurtësinë e

1) Në një formë të reduktuar ky artikull është kumtuar prej nesh më 4.XI.1964 në sesionin shkencor të organizuar nga Instituti i historisë dhe i gjuhësisë me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të atdheut; varianti i gjerë i tij u diskutua në redaksinë e revistës SF më 1966.

2) E. Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*; Bulet. i Universitetit Shtetëror të Tiranës», 2, 1957, 207.

3) E. Çabej, artikull i cituar, 207-213.

një zanoreje në gjuhën e sotme nuk peshon aq fort theksimi i saj, as vendi që ajo ka brenda fjalës, sa peshon një kriter historik, puna nëse kjo gjatësi është vazhdimi i një gjatësie origjinale të herëshme apo jo». Me fjalë të tjera, zanoret «janë të gjata sa kohë që reflektojnë një gjatësi të mëparme: qoftë që kjo të rrjedhë nga një zanore e gjatë e periodës parashqiptare, qoftë që të jetë rezultat i shkrirjes së disa tingujve, e cila u shkaktua sidomos nga zhdukja e rrokjes që vinte pas»<sup>4</sup>. Kuantiteti i zanoreve të shqipes është trajtuar gjerë edhe në dispen-sën e A. Dodit<sup>5</sup>. Autori në kapitullin «Kuantiteti ose gjatësia e tingujve të shqipes» nuk bën vetëm një paraqitje sintetike të dijës së mëparshme, duke përdorur edhe rezultatet e arritura në disa punime dialektologjike<sup>6</sup> atëhere të pabotuara, por jep edhe mendime veti-ake me interes. Më të rëndësishmet janë këto: 1) Kapitulli në fjalë për-mban në fillim disa konsiderata të përgjithshme teorike, të cilat jo të gjitha janë karakteristike për kuantitetin e zanoreve të shqipes; 2) Përshkruan kuantitetin në toskërishten e gegërishten e në këtë përshkrim ka disa të dhëna që jepen për herë të parë nga A. Dodi; 3) Autori konstaton se edhe në gegërishte gjatësia kompensatore ka filluar të lëkundet, megjithëse këtë konstatim të drejtë ai nuk e mbështet në asnjë fakt; 4) Së fundi, A. Dodi ka njohur dhe ka përgjithësuar vlerën fonologjike të gjatësisë, si tipar të të gjitha të fol-meve të Veriut<sup>7</sup>. Përveç këtyre anëve pozitive, në kapitullin e A. Do-dit gjenden pohime që për mendimin tonë nuk qëndrojnë, ka gjithashtu materiale faktike jo të vërteta. Këto shfaqje do të vihen në dukje më poshtë në parashtrimin e lëndës.

Zanoret e gjata trajtohen edhe nga J. Gjinari<sup>8</sup>. Autori pasi për-sërit disa konstatime të bëra nga gjuhëtarë të ndryshëm para tij, i ndan zanoret e gjata në dy grupe: 1) Zanore të gjata të herëshme; 2) Zanore të gjata relativisht më të vona, të ardhura si rezultat i zhvi-llimit fonetik që ka pësuar fjala. J. Gjinari nuk flet as për zanoret e gjatësisë së mesme as për zanoret e shkurtëra. Përveç kësaj, autori ka bërë një pohim që për mendimin tonë është i paplotë. Ai thotë: «Kur i krahasojmë të folmet e gjuhës shqipe lidhur me gjatësinë e zanoreve, del se ato ndryshojnë vetëm në zanoret e gjata...»<sup>9</sup>. Faktet tregojnë se të folmet e shqipes në punë të kuantitetit ndryshojnë jo vetëm në zanoret e gjata, por edhe në zanoret e gjatësisë së mesme.

Nga paraqitja e mësipërme e gjendjes së studimit të kuantitetit të zanoreve rezulton se deri vonë dihehin vetëm gjërat më kryesore lidhur me kuantitetin. Vetë E. Çabej pohon me të drejtë në artikullin e 1957 se «përsa u përket hollësivët, ne këtu ecim ende krejt në të errët, aq më shumë, me që përbrenda gegërishtes si edhe toskërishtes

4) E. Çabej, artikull i cituar, 208.

5) A. Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, 1963, 72-77.

6) M. Çeliku., *Vërejtje për të folmen e Dumresë; Të dhëna për të folmen e Kërrabës*, në BUSHT, Nr. 2, 1963; S.F., Nr. 2, 1966); B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, Nr. 2, 1962, M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në SF Nr. 1, 1964.

7) Para A. Dodit vlerën fonologjike të gjatësisë e ka njohur për të folmet e Dum-resë e Kërrabës M. Çeliku.

8) J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, 1963, 23-24.

9) J. Gjinari, *Dispensë e cituar*, 23.

ekzistojnë ndryshime të mëdha krahinore». <sup>10</sup> Për ndryshime kuantitative përbrenda gegërishtes kanë bërë fjalë edhe gjuhëtarë të tjerë <sup>11</sup>, por këto ndryshime gjer më sot njihen fare pak.

Ndërkaq kuantiteti i zanoreve ka filluar të hulumtohet në të folmet e Veriut e të trajtohet në punime dialektologjike, disa nga të cilat janë akoma të pabotuara.

Megjithëse janë bërë objekt studimi shumë të folme të shqipes, ne mendojmë se vështrimi i këtij fenomeni nuk ka ecur aqë përpara sidomos për të folmet e toskërishtes. Dhe me të vërtetë, në shumicën e skicave dialektore, që u kushtohen të folmeve toske kjo dukuri nuk trajtohet aspak (këtu kemi parasysh, në radhë të parë, gjatësinë e mesme dhe shkurtësinë).

Besojmë se interes nuk paraqet vetëm vështrimi i kuantitetit në zonat margjinale të dialektit jugor, në të cilat, siç dihet, gjatësitë ndihen mirë edhe sot <sup>12</sup>, por kjo dukuri duhet të ndiqet në të gjitha të folmet e dialektit jugor, duke përfshirë edhe toskërishten veriore të mirëfilltë, të cilës përgjithësisht i njohin dy shkallë të kuantitetit, gjatësinë e mesme dhe shkurtësinë.

Në këto rrethana, lind nevoja për të hulumtuar në detaja, më thellësisht, dallimet kuantitative të zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes. E pikërisht kësaj gjëje do t'i kushtohet, në radhë të parë, artikulli ynë.

Besojmë se hollësitë, megjithëse të kufizuara, që do të japim më poshtë për kuantitetin, do të kenë interes për studimet e mëtejshme të kësaj teme jo vetëm për dialektologjinë shqiptare por edhe për gjuhën letrare shqipe, për studimin e normës drejtshqiptimore të saj.

Është e pamundur që në këtë artikull të bëhet një përshkrim krahasues i plotë i shkallëve të shkurtësisë, të gjatësisë së mesme dhe të gjatësisë, për të gjitha të folmet e shqipes, duke kapur edhe të gjitha dallimet kuantitative të zanoreve që ekzistojnë sot. Një punë e këtillë do të kërkonte gjurmime të posaçme në çdo të folme të shqipes.

Ne i kemi vënë vehtes për detyrë në këtë artikull të japim, sipas konstatimeve tona, dallimet më kryesore kuantitative që ekzistojnë sot në një numër relativisht të madh qendrash të banuara, kryesisht nga Shqipëria e Mesme.

Paraqitja e shkallëve të kuantitetit në këtë artikull do të bëhet sipas pozicionit fonetik, në të cilin ndodhet zanorja e theksuar; megjithatë lënda për çdo pozicion do të jepet e grupuar sipas formave të ndryshme gramatikore të fjalëve, që kanë interes dialektor lidhur me shkallët e kuantitetit. Por, siç do të shihet edhe më poshtë, zanoret e theksuara në të njëjtin pozicion fonetik, në të njëjtën formë fjalë, në të dy dialektet e shqipes, në të folmet e ndryshme ose në kufitë e një të folmeje, kanë kuantitet të shkallëve të ndryshme.

10) E. Çabej, *Artikull i cituar*, 208.

11) G. Weigand, *Albanesische Grammatik im Südgeghischen Dialekt (Durazzo, Elbasan, Tirana)*, 1913, 5, Shënimi 2; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 6.

12) Shih 1) I.D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, 10; 2) E. Çabej, *Art. i cituar*, 207; 3) M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, «Studime Filologjike», 1, 1964, 133-136.

Përveç detyrës së sipërpërmëndur, do të përpiqemi të nxjerrim edhe disa përfundime lidhur me kuantitetin, që na i sugjeron vetë materiali faktik.

Natyrisht, në artikull në disa raste do të përpiqemi të korrigjojmë, të precizojmë e të saktësojmë disa pohime a të dhëna të pasakta për kuantitetin e zanoreve të shqipes.

Gjatë disa vjetëve ne kemi hetuar sidomos kuantitetin e zanoreve të theksuara në të folmet e Shqipërisë së Mesme; kemi mbledhur materiale në 66 qendra të banuara të kësaj treve, prandaj më poshtë për ilustrim do të ekspozojmë më shumë materiale nga kjo trevë.<sup>13</sup>

Për të bërë një krahasim sado të pjesëshëm të kuantitetit në këtë zonë me kuantitetin e zanoreve të theksuara në zona të tjera, ne, me anën e një ekspedite të organizuar posaçërisht më 1964, e ndoqëm këtë dukuri edhe për disa qendra të tjera të banuara si për Korçën (qytet), Vlorën (qytet), Shkodrën (qytet), Kurveleshin (Kuç, Nivicë) e Çamërinë (Volë). Në Lurë kemi mbledhur materiale në 3 pika.

Përveç materialeve tona, ne kemi në dorë edhe të dhëna e materiale të mbledhura nga të tjerë, kështu materialet për Kurveleshin, Shkrelin e Dibrën (Luzni, Reç e Dardhë), Nikaj-Mërturin, Zerqanin (Peladhi), m'i kanë vënë në dispozicion përkatësisht këta shokë: M. Totoni<sup>14</sup>, B. Beci, E. Lafe, E. Hysa. Materialet e këtyre shokëve i kemi pasur parasysh pjesërisht, duke dashur t'u shmangemi interpretimeve subjektive të bëra nga studjues të ndryshëm; të dhënat e tyre ne i kemi përdorur atëhere kur përputheshin me interpretimet tona.

Ky artikull përbën përpjekjen e parë për të njohur në mënyrë të detajuar gjendjen e të tri shkallëve të kuantitetit të zanoreve të

13) Këtu po radhisim të gjitha qendrat e banuara, në fillim krahinën, pastaj katundin, në parantez po japim edhe siglën përkatëse: 1) Peqin, Qytet (P.Q.), 2) Peqin, Vrap (P. Vr.), 3) Peqin, Pajovë (P.Pa), 4) Dumre, Belësh (D.B.); 5) Dumre, Gryksh (D. Gr.), 6) Dumre, Gjyralë (D.Gj.), 7) Kërrabë, Kërrabë e Vogël (Krr. V.), 8) Kërrabë, Gracë (Krr. Gr), 9) Kërrabë, Tërbaç (Krr. T.), 10) Kërrabë, Pajengë (Krr. Paj.), 11) Lurë, Fushë Lurë (L.F.), 12) Lurë, Gur Lurë (L.G.), 13) Martanesh (M.), 14) Grykë e Zaranikës, Mollogjesh (Gr. Z.M.), 15) Grykë e Zaranikës, Bixëllezë (Gr. Z.B.), 16) Darsi e Peqinit, Thanasaj (D.P.Th.), 17) Darsi e Peqinit, Kurtaj (D.P.K.), 18) Darsi e Peqinit, Asxhijas (D.P.A.), 19) Elbasan, Qytet (Elb.Q.), 20) Kërrabë, Kus (Krr.K.), 21) Kërrabë, Plangaricë (Krr.Pl.), 22) Kërrabë, Bodin (Krr.B.), 23) Shpat, Gjinar (Sh.Gj.), 24) Shpat, Trepanisht (Sh.Tr.), 25) Shpat, Shtërmën (Sh.Sht.), 26) Shpat, Zavalinë (Sh.Z.), 27) Rrogozhinë (Rr.), 28) Rrogozhinë, Koçaj, (Rr.K.), 29) Kavajë, Rreth-Greth (K.Rr.Gr.), 30) Kavajë, Kryevindh (K.K.), 31) Kavajë, Qytet (K.Q.), 32) Kavajë, Kryezi (K.Kr.); 33) Kavajë, Cikallesh (K.C.), 34) Durrës, Qytet (D.Q.), 35) Durrës, Bozanxhije (D.B.), 36) Durrës, Memje (D.M.), 37) Çermënikë, Zgosht (Ç.Zg.), 38) Çermënikë, Letëm (Ç.L.), 39) Çermënikë, Lunik (Ç.Lu.), 40) Çermënikë, Prevallë (Ç.Pr.), 41) Çermënikë, Kostejë (Ç.K.), 42) Çermënikë, Funarës (Ç.F.), 43) Shijak, Qytet (Sh.Q.), 44) Shijak, Shahinaj (Sh. Sh.), 45) Shijak, Sukth (Sh.S.), 46) Ndroq, Kërçukje (Nd.K.), 47) Ndroq (Ndr.), 48) Pezë, Maknor (P.M.), 49) Ishëm (I.), 50) Ishëm, Bizë (I.B.), 51) Prezë (Pre.), 52) Maminas (Ma.), 53) Maminas, Radë (Ma.R.), 54) Petrelë (P.), 55) Petrelë, Musqeta (P.M.), 56) Tiranë, Sauqet (T.S.), 57) Tiranë, Mënik (T.M.), 58) Tiranë, Mëzez (T.Mëz.), 59) Vërçë, Poroçan i Poshtëm, (V.P.P.), 60) Vërçë, Shënepremte, (V.Sh.), 61) Vërçë, Snosëm (V.S.); 62) Zall Herr (Z.H.), 63) Zall Herr, Herraj (Z.H.H.), 64) Shëngjergj (Sh.), 65) Shupal, Qafmollë (Sh.Q.), 66) Dajt, Priskë e Madhe (D.Pr.M.).

14) Nga M. Totoni kam pasur në dorë materialet e mbledhura prej tij në disa fshatra të Kurveleshit. Këto materiale i kam përdorur kryesisht në cilësinë e kuestionarit tematik në hulumtimin e kuantitetit të zanoreve në Levan të Fierit në banorët e Kurveleshit të vendosur aty.

theksuara në disa të folme të caktuara të të dy dialekteve të shqipes, pra ndaj tabelloja mbi gjendjen e shkallëve të kuantitetit të zanoreve të theksuara, që do të jepet më poshtë, do të plotësohet në të ardhmen me përshkrime e të dhëna për të folme të tjera, gjithashtu edhe me vështrime më të thella e më precize (këtu kemi parasysh matjet ekzakte laboratorike) për të folmet e eksploruara prej nesh. Kjo punë mbetet për t'u bërë në të ardhmen.

I pastudjuar është gjer më sot edhe kuantiteti i zanoreve të theksuara të gjuhës letrare kombëtare shqipe. Edhe në këtë aspekt sot vihen re rregulla, ndonjë prej të cilëve do të vihet në dukje më poshtë.

Vështrimi i kuantitetit të zanoreve për çdo njeri mund të jetë subjektiv sa kohë që bëhet jo në bazë të një matjeje laboratorike, ku do të dilte sa morësh është çdo shkallë e kuantitetit të zanoreve në gjuhën shqipe. Kjo gjë bën që konkluzionet të shihen gjithnjë me rezervën e duhur. Besojmë se ajo që na largon nga një subjekti-vizëm i theksuar në këtë mes është fakti se ne e kemi ndjekur këtë dukuri me të njëjtin vesh, si të thuash, me të njëjtin matës, duke i krahasuar gjithmonë të dhënat njëra me tjetrën. Materialin ilustrativ po e japim të bollshëm meqenëse kemi parasysh karakterin përshkrues të punimit.

\*

Në dialektet e shqipes konstatohen dallime, ndryshime të shkallëve të kuantitetit të zanoreve të theksuara, në forma të njëjta gramatikore, në pozicion të njëjtë fonetik.

Madje vihet re herë-herë një gjendje krejt e ndryshme. Kjo shpjegohet me shumë faktorë, ndër të cilët më të rëndësishmit besoj të jenë rënja e tingullit ose e tingujve që ndodheshin pas zanores së theksuar si dhe kontraksionet e disa tingujve.

Këto ndryshime mund t'i ndajmë në disa grupe:

a) Ndryshime të tri shkallëve të kuantitetit: të gjatësisë, të gjatësisë së mesme dhe të shkurtësisë, dmth. zanorja në të njëjtën formë fjale dëgjohet e mesme, e gjatë ose e shkurtër (*dre.kë* > *dre:k* > *drek*)<sup>15</sup>.

b) Ndryshime të dy shkallëve të kuantitetit: të gjatësisë e të shkurtësisë, dmth. zanorja në të njëjtën formë fjale dëgjohet e gjatë ose e shkurtër (*gu:r* > *gur*).

c) Ndryshime të dy shkallëve të kuantitetit: të gjatësisë së mesme dhe të shkurtësisë, dmth. zanorja në të njëjtën formë fjale dëgjohet e mesme ose e shkurtër (*ka.u* > *kau*; *puno.ı* > *punoj*, e kryera e thjeshtë, vet. III nj.).

Kemi konstatuar se ndryshimet e shkallëve të kuantitetit vërehen kryesisht në gjatësinë kompensatore dhe më rallë «në gjatësinë origjinale të herëshme». Por ka edhe raste të tjera ndryshimesh, si rastet ku zanorja e theksuar fundore e fjalëve mbaron me *-ar* ose, kur zanorja e theksuar është fundore.

15) Për të shprehur shkallët e gjatësisë po përdorim shenjat: (për gjatësi, në vend të — tradicionale); (për gjatësinë e mesme); asnjë shenjë (për shkurtësi, në vend të v tradicionale).

A) *Kuantiteti i zanores së theksuar në rrokje të mbyllur.*

I. *Kuantiteti i zanores së theksuar në rrokje të mbyllur fundore*  
*Format e trajtës së pashquar njëjës të emrave mashkullorë që dalin në temë me bashkëtingëllore.*

§ 1. Zanoret e theksuara të emrave mashkullorë janë zakonisht të shkurtëra kur ndodhen në rrokje të mbyllur fundore; emrat mund të jenë prej një a më shumë rrokjesh: *bilbil, dash, gardh, gjak, mal, plak, shok, shtet, zog.*

Siç do të shohim më poshtë, për arsye të ndryshme nga ky rregull ka edhe përjashtime.

Shkurtësia e zanoreve të theksuara në rrokje të mbyllur është vënë re më parë nga shumë gjuhëtarë. Shkurtësia e këtyre zanoreve është karakteristike për të gjitha të folmet e shqipes. Në këtë pikë të folmet e shqipes nuk dallojnë. Besojmë që kuantiteti i zanores së këtij pozicioni në gjuhën e sotme shqipe duhet interpretuar si kuantitet pozicional.

*Format e trajtës së pashquar njëjës të disa emrave mashkullorë që dalin në temë me r, ll, t e etj.*

§ 2. Në dialektin e Veriut dhe në disa të folme jugore toske, që e njohin shkallën e gjatësisë, disa emra mashkullorë që sosin në temë me -r e kanë rregullisht të gjatë zanoren e theksuar: *ushta:r, lta:r* (T. Mëz.), *gu:r* (T.M.), *gamo:r* (Herraj), *sama:r, mulla:r, shqipta:r* (Ç. Zg.), *paza:r, ba:r, mu:r* (Ç.L.), *bulla:r, bi:r, hama:r, hoshma:r, zinchi:r, sqepa:r, flamur* (Elbasan); po kështu në Mat: *buna:r, goma:r, gu:r, kajkata:r, kosha:r*<sup>16</sup>, në Nikaj-Mërtur: *katunda:r, kumba:r, shqipta:r, xhanda:r* etj.<sup>17</sup>, në Shkodër (te format e njëjës): *gu:r, ushta:r, buqa:r, beqa:r, gaoma:r, gjyteta:r, katuna:r, qese:r, mulla:r, tina:r, buli:r* (M.), *maxha:r* (L.F.), *kulma:r* (Sh.S.), *gashta:r* (D.Pr.M.), *dama:r* (Z.H.), në Tropojë: *uga:r, çapur, buna:r, qyteta:r*<sup>18</sup>. E njëjta gjë vihet re edhe në disa të folme kalimtare (Shpat, Dumre, Darsi e Peqinit), *ba:r, bi:r, goma:r, vggjë:r, pena:r* (Shpat). Gjatësi në rrokjen fundore të mbyllur nga -r vejmë re edhe në disa të folme jugore toske: *ba:r, bulla:r, lopa:r, ushta:r, gu:r, shu:r* (Bregdet i Poshtëm)<sup>19</sup>, *ushta:r, goma:r, mu:r, qiteta:r, fshata:r, ba:r, beha:r, mulla:r* (Kuç), *jena:r, fleva:r, ba:r, mulla:r, goma:r, gu:r, ushta:r*, (Volë, Çamëri). Në dialektin e Veriut zanorja në këtë pozicion fonetik del e shkurtër në raste fare të rralla.

Vetëm në Letëm të Çermënikës (katund në kufi me Mokrrën) dëgjohen *bar, gomar, meçkar* (një lloj druri). Shkurtësia në këtë pozicion besoj të jetë ndikim i të folmes fqinje të Mokrrës.

Përjashtim nga tendenca e përgjithshme bëjnë edhe disa fjalë të huazuara nga turqishtja. Fjala *sheqer* (ose varianti fonetik mjaft i përhapur *shelqer*) takohet me zanore të gjatë (*sheqe:r*) në të folmen e qytetit të Elbasanit, në disa katunde rreth Elbasanit (Gr.Z.) dhe në Çermënikë (Zgosht, Neshtë) etj., ndërsa në të gjitha të folmet e tjera, ku ne kemi mbledhur materiale, dëgjohet rregullisht me zanore të shkurtër (*sheqer, shelqer*).

16) B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, «Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 2, 1962, 241.

17) E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, «Studime Filologjike», 3, 1964.

18) J. Gjinari, *Vërejtja mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, «Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 4, 1963, 173.

19) M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, «Stud. Filologjike», 1, 1964, 134.

Duhet të kemi parasysh se zanoret e fjalëve të marra nga turqishtja nuk ruajnë gjithmonë atë kuantitet që kanë edhe në turqishte, ashtu siç nuk ruajnë gjithmonë edhe theksin. Kështu fjala me origjinë turke *qef* del herë me zanore të gjatë (*qe:f*, T.S., Elbasan, Sh. Z., Sh. Sh.) herë me zanore të shkurtër si në turqishte (*qef*, M., Rr., Sh. Gj., *qejf*, Vlorë, Neshtë, Çermënikë). Përgjithësisht shkurtësi kemi në gegërishte edhe në këto fjalë turke: *qeder*, *asqer*, *haber* etj., por nga ana tjetër: *beha:r*, *yzmeqa:r*; në Elbasan edhe *qymy:r*, por *qymyr* në Durrës. Në Bregdetin e Poshtëm (sipas M. Totonit) *asqe:r*, *habe:r*.

Ndryshe paraqitet kuantiteti i zanoreve të theksuara i këtij pozicioni fonetik në të folmet e dialektit të Jugut, që s'e kanë shkallën e gjatësisë. Në Korçë edhe Vlorë në këtë rast ka rregullisht shkurtësi: *gomar*, *lopçar*, *piper*, *fener*, *fetar*, *sheqer*, *qeshor*, *yzmeqar* (Korçë); *gomar*, *gur*, *bar*, *lopar*, *bullar*, *ushtar*, *litar*, *sheqer*, *zinxhir*, *hambar*, *strumbullar*, *qytetar*, *peshqir*, *fshatar*, *samar* (Vlorë). Këtu është e nevojshme të shënojmë se shkurtësia e zanoreve të ndjekura nga *-r* është pak më e gjatë nga shkurtësia e zakonshme (*dash*). Pastaj materiali që dhamë më sipër jep shfaqjen më karakteristike edhe jo ato individuale; p.sh. gjenden subjekte në qytetin e Vlorës<sup>20</sup>, që ruajnë gjatësinë e të folmes nga kanë ardhur (*gu:r*, *ba:r*, *mu:r* etj.). Në të folmen kalimtare të Vërçës (Snosëm, Poroçan i Zi) në format e njëjësit zanorja është e shkurtër ashtu si në Jugë: *pishtar*, *gomar*, *ushtar*, *bar* (Snosëm), *gur*, *gomar* (Poroçan i Zi).

Mendojmë se gjatësia e emrave të tipit *gu:r* duhet të shpjegohet kryesisht me natyrën e bashkëtingëllores *r* që pason zanoren<sup>21</sup>. Në fjalët turke gjatësia duhet parë si shtrirje analogjike (kur ato shqiptohen me zanore të gjatë) dhe si ruajtje të shqiptimit turk (kur ato shqiptohen me zanore të shkurtëra). Por në fjalë të caktuara gjatësia mund të jetë reflektimi i gjatësisë që ka edhe turqishtja (*zullumqa:r*).

§ 3. Në disa emra mashkullorë vihet re gjatësi në rrokjen e theksuar fundore të mbyllur nga një *-ll*. Në të folmet gege kemi takuar këta emra: *de:ll*, *kiçmi:ll* (T.M., T. Mëz.), *y:ll* (T.S.), *za:ll* (Herraj), *kaçami:ll*, *he:ll*, *de:ll*, *y:ll* (Shkodër), *pri:ll*, *qu:ll*, *ma:ll* («dhimbje që na ze për njerëzit tanë e për atdhe, kur jemi larg tyre» F.I.Sh., 1954), *thënji:ll*, *py:ll*<sup>22</sup> (Elbasan), *za:ll*, *qu:ll* (Peqin), *he:ll*, *za:ll* (Luzni, Dibër), *hy:ll*, *he:ll*, *thëni:ll* (Shkrel), *za:ll*, *y:ll*, *kaçmi:ll* (M.).

Të gjata janë edhe zanoret e theksuara të përfutuara nga monoftongimi i një diftongu dhe që pasohen nga bashkëtingëllorja *-ll*: *di:ll*, *qi:ll*, *mi:ll*, *fy:ll* (në Shkodër *fe:ll*), *kapërcy:ll* (në Herraj *kapërce:ll*), *bu:ll*. E gjatë është natyrisht edhe zanorja e disa emrave dikur asnjans që dalin më *-ë*, e cila sot nuk shqiptohet në gegërishte: *dy:ll*, *ba:ll*.

Zanorja e theksuar fundore e ndjekur nga *-ll* është e gjatë edhe në të folmet toske që e njohin sot gjatësinë; në Kuç të Kurveleshit

20) P.sh. Alem Sefer Gjirkondi i ardhur në qytetin e Vlorës nga Malësia e Vlorës (Vranisht).

21) Kështu ngjet p.sh. edhe në «frenqjishte, ku para bashkëtingëlloreve të tingëllta *r*, *z*, *v*, *zh*, të ndodhura në fund të fjalëve, zanorja e theksuar zgjatet më shumë fuqi»; M.I. Matuseviç, *Vjedjenije vobshuju fonjetiku*, botim i III, 1959, 90.

22) Emri *py:ll* në Elbasan del në gjininë mashkullore *py:ll-pylli*, por në shumë të folme gege (Tiranë, Durrës, Ishëm etj.) del në gjininë femërore *py:ll — pylla*.

dëgjohet: *i:ll, gë(r)mi:ll, pri:ll, qu:ll, he:ll, dja:ll*; në Volë (Çamëri): *i:ll, pri:ll, qu:ll*; në Bregdetin e Poshtëm<sup>23</sup> *kërmi:ll, konji:ll, pri:ll, qu:ll*.

Në shumë të folme të tjera toske zanorja në këto kushte fonetike dëgjohet e shkurtër. Në Korçë kemi dëgjuar: *qull, yll, pyll*; në Vlorë: *ckërmill, hell, dell, zall, yll*.

Në të folmet kalimtare diku kemi gjatësi diku shkurtësi. Kështu në Shpat, Dumre, Darsi e Peqinit zanorja është e gjatë, në Vërgjë te disa fjalë zanorja e theksuar është e gjatë (*thëngji:ll, y:ll, Shënepremte, Snosëm*), tek disa të tjera e shkurtër (*kërmill, Shënepremte; prill, Snosëm; hell, Poroçan i Zi*), por *yll* edhe në Thanasaj (Darësi e Peqinit).

Ka raste kur zanorja e theksuar e këtij pozicioni fonetik është e shkurtër edhe në Veri: *mall* («pasuri e patundshme...» F.I.Sh., 1954), *kavall, portokall, hamall, çakall, shall*. Në të folme të veçanta gege është e shkurtër edhe zanorja e theksuar e ndonjë emri, që më rëndom është e gjatë: *kaçmill, (Sh.), thënil* (K.C., P.M.).

Për të shpjeguar gjatësinë e zanores së theksuar në emrat e tipit *y:ll*, megjithë vështirësitë që paraqiten, ndihmon, në radhë të parë, teza e E. Çabejt mbi kriterin historik «puna në se kjo gjatësi është vazhdimi i një gjatësie origjinale të herëshme apo jo»<sup>24</sup>. Sipas këtij kriteri, bëhet e qartë se gjatësia e zanores në fjalën *py:ll*, është gjatësi e herëshme që ruhet edhe sot e që u përftua si rezultat i një kontraksioni që ndodhi në këtë fjalë.<sup>25</sup> Ky kriter mund të zbatohet edhe për fjalë të tjera, duke përfshirë këtu si vështrimin e temës më të hershme të tyre, ashtu dhe trajtat e shqiptimit të tyre në gjuhët nga mund të jenë huajtur. Ndër të tjera, gjatësinë e disave prej këtyre emrave mund ta interpretojmë si gjatësi kompensatore të tipit të vonë, dmth. me rënje të ë fundore e me monoftongimin e një diftongu, por ne nuk përjashtojmë këtu edhe rolin e analogjisë për disa fjalë të caktuara. Një gjë duhet të kihet parasysh: në trajtën e shquar gjatësia e zanores kalon përgjithësisht në gegërishte në gjatësi të mesme (*qu:ll — qu:lli*). Ndërkaqë në formën e shumësit ndodh shumë herë shkurtimi i gjatësisë, që arrin (te shumësat me jotizim të -ll) gjer në nivelin e zanoreve të shkurtëra: *y:ll > yj, de:ll > dej, thëni:ll > thënij*; ose *y:ll > yst* (Çermënikë: Prevallë, Neshtë, Kostejë), por *y:s* (Çermënikë: Letëm, Lunik, Martanesh); *gërmi:ll > gërmij* (Kuç), *konji:ll > konjij* (Bregdet i Poshtëm).

§ 4. Janë edhe disa emra të tjerë mashkullorë, zanorja e theksuar e të cilëve, ndërsa në dialektin e Veriut dhe në disa të folme toske periferike është e gjatë, në shumicën e të folmeve toske rezulton e shkurtër. Këto fjalë janë mjaft të kufizuara në numër.

Emri *det* në të gjitha të folmet gege shqiptohet rregullisht me zanore të gjatë (*de:t*). Po kështu edhe në disa të folme toske jugore (Kurvelesh, Çamëri, Bregdet i Poshtëm); madje, këtu gjatësia është më e theksuar, kemi stërgjatësi. Në gegërishte në rrokje të haptë mes fjale gjatësia nuk ruhet (*de:ti*), në të folmet toske jugore ruhet (*de:ti*, Kuç; sipas M. Totonit edhe në Bregdetin e Poshtëm). Në të folmet toske jo periferike gjatësia ka kaluar në shkurtësi. Në Korçë, Vlorë

23) M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, «Stud. Filologjike», 1, 1964, 134.

24) E. Çabej, *Artikull i cituar*, 208.

25) E. Çabej, *Po aty*, 210.

dëgjohet e shkurtër (*det*); po kështu në Rreth-Greth të Kavajës, banorët e të cilit janë të ardhur prej kohësh nga një trevë poshtë Shkumbinit (*det*). Në Sh.Sh. del e shkurtër në përdorimin mbiemëror të fjalës: *boj det*. Kjo fjalë ruan sot një gjatësi të hershme<sup>26</sup>. Po këto vërejtje vlejné edhe për *ku:t-kuti*; vetëm se, në krahasim me *de:t*, te *ku:t* gjatësia është tronditur më shumë në gegërishte (p.sh. në Peladhi *kut*). Në të gjitha qendrat e banuara të eksploruara prej mesh kemi gjurmuar gjatësinë e zanores së theksuar të emrit *shat*. Kudo në dialektin e Veriut ajo rezulton e gjatë, megjithëse rregullisht emri në këtë trevë është i gjinisë mashkullore (vetëm në disa të folme toske është femëror). Gjatësi, madje më e theksuar, vërehet në Kurvelesh, Çamëri, Bregdet i Poshtëm (në Kuç ajo ruhet edhe në rrokje të mezit: *sha:t* > *sha:ti* > *shetër*). Në gegërishte shpesh takohet shumësi *shy.tën*.

Emri *djalë* në të folmet gege dhe në të folmet toske jugore del përgjithësisht me zanore të theksuar të gjatë. Në Kuç te kjo fjalë nuk kemi stërgjatësi. Në shumës me shkurtësi (*djem, djelm, djel*), në rrokje të haptë mes fjale kemi gjatësi të mesme (*dja.li*). Në të folmet e tjera toske del me zanore të shkurtër ose të mesme (në Vlorë: *djal*, në Korçë: *dja.l(ë)* me ë fundore të reduktuar). Meqenëse Buzuku këtë emër e përdor si asnjans<sup>27</sup>, besojmë se gjatësia e zanores së theksuar duhet interpretuar si gjatësi kompensatore, e përftuar nga rënja e ë-së fundore. Këtë gjë e dëshmon sot edhe trajta toske me ë fundore që ruhet gjysëm e reduktuar ose e plotë. Ato vërejtje që dhamë për *djalë*, vlejné edhe për emrin mashkullor *ka:l*, vetëm se në Kuç dëgjohet me stërgjatësi (në dallim nga *dja:l*); gjithashtu gjatësia e vokalit këtu është një gjatësi e herëshme<sup>28</sup>, më e herëshme se ajo e emrit *djalë*.

Me interes është edhe gjatësia e zanores tek *bujk*. Në dialektin e Veriut mbizotëron forma *bu:lk* për njëjësin dhe *bu:lq* për shumësin. Në Kuç: *bu:ik* (nj.) dhe *bu:q* (sh.). Në të folmet toske veriore dhe në disa të folme kalimtare *bujk*. Edhe kjo gjatësi mbetet për t'u interpretuar.

Në dialektin e Veriut *bu:ll-bulli* (<*buell*) dëgjohet edhe në shumës me zanore të gjatë, madje edhe në trajtën e shquar *bu:i - bu:it*. Por në Shkodër *bu:ll* (nj.) — *buj* (sh.), sikurse takohet për njëjës (një) *duj - duj* (trajtë e shquar). Se çfarë përfaqëson gjatësia te *bu:ll* > *bui* mbetet e pasqaruar plotësisht, a kemi këtu gjatësi të hershme, duke e kërkuar prejardhjen e fjalës, si shumë studjues të shqipes, te lat. *bubalus* (G. Meyeri Fj. et. 50) dhe *ue* ose *ua* si krijime analogjike përbrenda njërit apo tjetrit dialekt, apo gjatësi kompensatore të përftuar nga monoftongimi i *ue* (duke kërkuar kështu një etimologji tjetër të fjalës, shih. E. Çabej, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, Bulet. Universitetit Shtet. të Tiranës, 4, 1960, f. 72). Gjatësia e ruajtur edhe sot shumë mirë e bën më të pranueshme prejardhjen latine të fjalës.

26) E. Çabej, 1) *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe III*; «Buletin i USHT», 2, 1961, 50-51, 2) *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, 2, 1957, 209.

27) E. Çabej, *Po aty*, 62.

28) E. Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», 2, 1957, 209.

*Format e trajtës së shquar njëjës të emrave mashkullorë  
në rasën kallëzore.*

§ 5. Kur përpara mbaresës së lakimit të shquar nuk del asnjë zanore epentetike, zanorja e theksuar në ndonjë të folme gege është rregullisht e gjatë, pavarësisht nga lloji i bashkëtingëllores fundore të temës; kështu p.sh. në Shëngjergj të Tiranës: *da:shn*, *le:shn*, *ba:rn*, *bu:rrn*, *kula:rn*, *za:lln*, *the:sn*; më rrallë dëgjohet e tillë zanorja edhe në të folme të tjera: *gu:rn* (Ç.L.), *goma:rn* (T.S.), *le:shn* (L.F.), *tella:lln* (P.M.).

E gjatë dëgjohet në shumë të folme gege edhe zanorja e theksuar e emrave, që sosin në temë me nazalen *-n*, e cila asimilohet me mbaresën *-n*: tun *çu:n* (T. Mëz, T.S.), e du: për *çu:n* (T.M.), vrit *fila:ôn* (T.M.), nuk e ke hak ma *ramaza:ôn* (T.M.), me *Elbasâ:n* i kemi pas bâ pazaret (M.), me *Limo:n* n'mal (Ç.L.), e mori ne ky *jorgâ:n* (Ç.L.), mlethte *katu:n* (Ç.L.), e hoq *duha:n* (Ç.Lu.), kam qa *zako:n* (G.Z.M.), s'e permurr *kaza:n* (Rr.K.), e shita *shejta:n* (Rr.K.), vu *kaza:n* (Ç.K.), tuj rujt *sta:n* (Ç.K.), t'kishte ma:rr *Ramaza:n* (P.), ti po s'hoqe *doho:n* ti nuk jâlë (Peqin), me *çu:n* qe:sh (Peqin), ç'e quïn *çu:n* (Krr. Gr.).

E gjatë është zanorja e theksuar edhe në disa raste të tjera, kur emri sos në temë me një bashkëtingëllore tjetër e cila asimilohet me mbaresën *-n*: t'vij gusht mush *mo:n* aj tjetri (Kërrabë), e *pa:sh* ne *Ahme:n* (Kërrabë), e kishte punu: Xhafa me *Tahi:r* (Ç.L.); si edhe në rastet ku *tn > t*: e pëlqen *muhabe:t* (Ç.L.), i ka mar *muza:t* (Ç. Zg.).

E gjatë është zakonisht zanorja e theksuar edhe në kallëzoren e emrave të tipit *hu-ni*: i merr *kallî:n* (Ç.L.), e shkula *hû:n* (Ç.Lu.), *hî:n* cipër (Gr. Z.M.), *mulli:n* e gjeta nrÿ: (P.M.), *shullâ:ôn* (Sh.), i hek *kallî:n* (D.Pr.M.), etj.

Në të folmet kalimtare tek emrat me temë më *-n* dhe tek ato, që sosin me një bashkëtingëllore tjetër e cila mund të asimilohet me mbaresën *-n*, zanorja e theksuar është në shumicën e rasteve e gjatë: ne e bâim me *Elbasa:n* pazarin (Dumre), ku e ke *hu:n* (Dumre), e thirrën *çu:n* tem (Sh.Z.), kishte da *dyqa:n* me perde (Sh.Z.), me *Ahme:n* na Berati (Sh.Z.), e *pa:sh* *goma:r* tan (Sh.Z.), do i ve:m *zja:rr* kasolles (Sh.Z.), ça:n *ka:l* (Sh.Gj.), largoje *qê:n* (V.Sh.), shitëm *ma:ll* (V.S.), i dorëzoj *dyqa:n* (V.S.), merr *çu:n* me vehte (V.S.), vrava *gjû:n* (V.S.), N. e kthef (ktheu) *goma:r*.

Në të gjitha këto forma arkaike të kallëzores gjatësia e zanores së theksuar është, për mendimin tonë, gjatësi kompensatore në pasojë të rënjes së tingujve fundore, ose në pasojë të një asimilimi që ka ndodhur në fund të fjalës.

Në format e kallëzores më rrallë takohet edhe shkalla e tretë, shkurtësia: *leshn* (T.Mëz.), *ukn* (T.M.), kur ja hek degës *kallin* (P.M.), me gjith *çun* (P.), e kthy:n *zakon* (Sh.S.), e bjejte *dohôn* (Pre.), *ka:llin* (Ma.R.), tune *çun* (Ma.), lidhe *qen* (D.Pr.M.), *drejtorn* (D.Pr.M.).

Në këto raste kemi kalim nga shkalla e gjatësisë në shkurtësi. Ky kalim ka ndodhur në analogji me shkurtësinë e tipit *lis*. Ndërmjet të tjerave, edhe këto fakte dëshmojnë një farë tronditje të shkallës së gjatësisë.

Ndryshe nga emrat që dalin në temë me bashkëtingëllore, në dialektin e Veriut emrat që sosin me zanore të theksuar e kanë zanoren e

theksuar të gjatë, saherëqë gjatësia vihet re edhe në trajtën e tyre të pashquar: *ka:n* (Herraj, Ç.Lu), merrte *ka:n* (Ç.Zg.), *shi:n* (Ç.Zg.), *t'vlla:n* (Ç.L.), prish *sy:n* (Rr.K.), *ka:n*, *shi:n* (Shkodër), *vlla:n* (D.B.), *ka:n* (D.B.), *ka:n* (M), *mi:n*, *ka:n*, *shi:n* (Ndroq), misri e don *shi:n* (P.), *mi:n* (P.), *ka:n* (P.), e zen gjaku *ka:n* (Sh.Sh.), *shi:n* (Sh.S.), *ka:n* (S.B.), *ka:n*, *mi:n* (Ma.R.), merrnje *ka:n* (D.Pr.M.), *shi:n* (D.Pr.M.), *ka:n*, *shî:n* (= shiu), *va:n* (Sh.), *mi:n*, *ka:n* (Sh.Q.), *ka:n*, *dhe:n*, *vlla:n* (Shkrel).

E njëjta gjë vërehet edhe në të folmet kalimtare: *ka:n*, *shi:n*, *sy:n* (Vërcë, Dumre, Shpat etj.).

Siç e ka vënë re me të drejtë edhe A. Dodi, gjatësia është bërë tipar i pandashëm i kësaj forme<sup>29</sup>. Megjithatë, po shenojmë këtu se emrat e këtij tipi që kanë zanore të shkurtër në trajtën e pashquar, e ruajnë shkurtësinë edhe në kallëzoren e shquar; shumicën e tyre e përbëjnë disa emra të marrura nga turqishtja: *Rizan* (Herraj, Sh.Q.), *Furchin* (T. Mëz. Ma.R.), *xhan* (K.Kr.), *Shyqyrin* (Ma.R.), *qeraxhin* (Sh.Sh.), *kadin* (Sh.Sh.), *Haxhin* (I. «dojte me vra *Haxhin*»), *Agan* (Ma.R., D. Pr. M.), *myftin* (K.C.).

Por në Elbasan, Shëngjergj e në ndonjë të folme tjetër geqe dëgjohen trajtat me gjatësi, pavarësisht se në të pashquarën zanoret e theksuara janë të shkurtëra: *aga* > *aga:n*; *Riza* > *Riza:n* etj.

Emri *be* (bej) del me *e:* (të gjatë) ose me *e* (të shkurtër): u kthy: me *be:n* (Ç.L.), s'e kishin frik *be:n* (Sh.Z.), *be:n* to:n e vra:n (Sh.Z.); qyqja paska knu: për *ben* (Sh.Z.), me Rifat *ben* (Sh.Q.), t'shkojshe me Beqir *Ben* (P.M.).

Me zanore të shkurtër del edhe ndonjë emër tjetër i këtij tipi që nuk është i huazuar nga turqishtja: *qîn* (Sh.S.=qingjin), shko merr *qîn* (T.M.), *qîn* (Kavajë); por në Sh. Q. *qî:n*.

Përsa u takon të folmeve toske konstatojmë dallime në këtë pikë. Zanoret e theksuara të emrave të këtij tipi mund të jenë të shkurtëra, të gjata dhe më rrallë të mesme. Në Vlorë kemi shkurtësi: *kan*, *dhen*, *tran*, *shin*, *ben* (edhe *bejn*); në Korçë në shumicën e rasteve shkurtësi: si macja me *min*, *kan*, por edhe *Alin*, *tran*; në Kuç e Volë gjatësi: *ka:n*, *shi:n*.

*Format e trajtës së pashquar njëjës të emrave femërorë, që sosin në temë me ë.*

§ 6. Në gegërishte ë-ja fundore e temës ka rënë rregullisht e për pasojë në përgjithësi zanorja e theksuar e rrokjes paraprise pëson zgjatim kompensator<sup>30</sup>. Meqënëse kjo lloj gjatësie njihet, po japim vetëm pak shembuj: *bu:k* (Elb. Q.), *go:c* (T.S.), *ko:s* (Ç.K.), *cu:c* (M.). Thamë në përgjithësi, sepse ka raste të rralla kur në të folme të ndryshme të gegërishtes zanorja e këtij pozicioni nuk është e gjatë.

29) A. Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1963, 76.

30) Të parët që na tërheqin vemëndjen mbi zgjatimin kompensator janë Gj. Pekmezi në *Gramatik der albanesischen sprache*, 1908; dhe G. Weigand, në *Albanesische Grammatik im Südgegischen Dialekt*, 1913. I pari ndalet më gjatë në këtë lloj gjatësie dhe, me të drejtë, e konsideron këtë si gjatësi të re, sekondare, tipike për gegërishten. Megjithatë sot, me përjashtim të disa të folmeve geqe të Veriut, në radhë të parë, kam parasysh të folmen e Shkodrës, neve nuk na duket se në gjithë gegërishten zgjatimi i ri kompensator është i një shkalle më të shkurtër (siç vëren Gj. Pekmezi) se sa «gjatësia e vjetër».

Kështu zanoret e theksuara të fjalëve *luftë, ditë* dalin gjithmonë të shkurtëra në të gjitha të folmet ku ne kemi mbledhur materiale (*luft, dit*). Gjithashtu në disa të folme kemi dëgjuar të shkurtëra zanoret e këtyre emrave: *eshk* (L.G.), *çorb* (P.M.), *goc* (Sh.S., D.B.), *qaf* (I), *dor* (I.B.), *ferr* (K.C.); por këto janë mjaft sporadike e nuk mund të mbahen si karakteristike për të folmet e mësipërme. Po kështu dëgjohej *mehall* (Shkrel), *paq* (Shkrel).

Në të folmen e Shkodrës zanoret e këtij pozicioni i kemi dëgjuar rëndom si zanore të mesme, ose si më të shkurtëra se të gjatat: *kry.p, dja.th, qe.p, pla.k, pi.sh, fri.k, do.r*. Këto janë format karakteristike për këtë të folme. Në Shkodër zanorja e këtij pozicioni dëgjohej në ndonjë rast edhe e shkurtër: *buk*.

Në të folmet kalimtare zanorja e këtij pozicioni zakonisht është e gjatë, por *kapic* (V.Sh.), *pen* (pendë, Sh. Sht.), *frik* (Sh.Z.). Shpesh dëgjohej e shkurtër edhe në Rreth-Greth (Bregdet i Poshtëm i Kavajës): *kâôm, pen, gazet, lafsh, lehon, melic*.

Ky tip zgjatimi kompensator nuk është karakteristik për dialektin e Jugut. Zanorja e theksuar e kësaj forme ka në Jugë dy shkallë të kuantitetit: gjatësi e mesme dhe shkurtësi; të dyja këto shkallë të kuantitetit mund të vihen re në të njëjtën të folme, por njëra shkallë shfaqet më rëndom e tjetra më rrallë. Për mendimin tonë, fakti në se një e folme toske ka zanore të gjatësisë së mesme apo shkurtësi lidhet me shkallën e reduktimit të ë-së fundore të fjalës. Duke e përshkruar gjendjen e sotme në vija të trasha mund të pohohet se sa herë që ë-ja fundore ruhet ose reduktohet deri në një farë shkalle, atëhere zanorja e theksuar është e mesme; sa herë që ajo është e reduktuar në shkallën zero, dmth, nuk dëgjohej fare, atëhere të shumtën e herëve kemi zanore të shkurtër; por në raste më të rralla ruhet shkalla e gjatësisë së mesme. Faktet vërtetojnë plotësisht konstatimin e Gj. Pekmezit që gjatësia e re kompensatore është tipike për gegërishten.<sup>31</sup>

Ja konkretisht: Në Korçë (qytet) sa herë që zanorja fundore ë dëgjohej, megjithëse reduktimi i saj është mjaft i dendur, zanorja e theksuar është e gjatësisë së mesme, e cila na duket pak më e gjatë se e mesmja e Elbasanit, sidomos tek ish-muslimanët (ë-ja e futur në parantez në shembujt që pasojnë tregon se ajo është e reduktuar): *bu.k(ë), fri.k(ë), lo.p(ë), pu.n(ë), qi.sh(ë)* etj. Gjatësia e mesme ruhet edhe në pak raste kur ë-ja fundore ka rënë plotësisht: *do.r, fri.k*. Gjatësia e mesme kalon në shkurtësi në shumicën e rasteve kur ë-ja fundore ka rënë fare: *buk, shosh, her, pashk*. Gjatësi e mesme dhe shkurtësi mund të takohen paralelisht tek i njëjti subjekt.

Në krahasim me Korçën (qytet), në të folmen e Vlorës (qytet) reduktimi i zanores fundore -ë ka ecur më përpara, e në këto raste, që përbëjnë shumicën, zanorja e theksuar dëgjohej e shkurtër: *arr, buk, drek, lop, krip, kok, pish, pulp, e shtun*. Kjo vlen edhe për fjalët me më shumë se një rrokje: *kolloçk, lopat, lëpushk*. Rastet kur në këto të folme ë-ja fundore ruhet, qoftë edhe mjaft e reduktuar, janë më të rralla se në Korçë, pastaj po shënojmë këtu se gjatësia e mesme e zanoreve të theksuara në Vlorë neve na duket se është më e shkurtër se gjatësia e mesme e Elbasanit, natyrisht vetëkupto-

31) Shih shënimin 30.

het edhe më e shkurtër se e mesmja e Korçës (qytet): *lu.g(ë)*, *pu.l(ë)*, *ko.ck(ë)*, *qi.sh(ë)*, *zo.rr(ë)*. Këto janë të dhënat më karakteristike për Vlorën (qytet); të cilat i kemi marrë nga tre subjekte, që e mbajnë vehten për vlonjatë. Në Bregdetin e Poshtëm «gjithashtu ndihen të shkurtëra zanoret e theksuara, që pas rënjes së ë-së fundore janë gjendur në rrokje të mbyllur: *lopat*, *ken*, *mjet*, *lidh*, *krip*, *hod*, *kok*, *buc*, *xhuf* etj.»<sup>32</sup>.

Në Kuç (Kurvelesh) ë-ja fundore nuk ruhet më dendur se në dy pikat e mësipërme; ajo takohet pothuajse aqë dendur sa në Korçë, por është më shumë e reduktuar. Zanorja e theksuar është e mesme, afër të gjatës; do të thoshim aq sa e mesmja e Korçës: *bu.k*, *bucje.l*, *shka.ll*, *lu.g*. Por krahas këtyre gjejmë edhe: *lo.p(ë)*, *bushi.c(ë)*, *dërra.s(ë)*, *dja.th(ë)*. Kemi vënë re se në shqiptimin e shpejtë ë-ja fundore dëgjohet më pak dhe zanorja e theksuar është pak më e gjatë se gjatësia e mesme, ndërsa në shqiptimin e ngadaltë, më të shkoqur, ë-ja fundore dëgjohet më shumë dhe zanorja e theksuar është e një gjatësie të mesme. Rastet kur zanorja e theksuar pas rënjes së ë-së fundore dëgjohet e shkurtër janë të rralla: *pik*, *shosh*, *sit*.

Në Volë (Çamëri) ë-ja fundore ruhet më mirë dhe zanorja e theksuar dëgjohet e mesme: *lo.pë*, *gje.llë*, *fu.rrë*, *sho.shë*, *qe.pë*, e *hë.në*, *pë.ndë*. Rastet kur zanorja e theksuar pas rënjes së ë-së fundore dëgjohet e shkurtër janë fare të rralla: *vjesht*, *flet*.

Nga sa u tha gjer këtu, rezulton se në dialektin e Jugut pas rënjes së ë-së fundore zanorja e theksuar ose ruan shkallën e gjatësisë së mesme, ose kalon në shkurtësi. Përderisa sot në të njëjtën të folme ruhen disa trajta tingëllore të së njëjtës formë gramatikore të emrave të këtij tipi që në fakt përbëjnë fazat e evolucionit të kuantitetit (*bu.k > bu.k > buk*), ne kemi të drejtë të mendojmë se në toskërishte jo menjëherë pas rënjes së ë-së fundore u shkaktua doemos shkurtimi i zanores së mesme. Shkurtimi i gjatësisë së mesme, ose i gjatësisë, siç do e shohim edhe më poshtë, duhet të ketë ndodhur në një fazë më të vonshme nga faza e rënjes së ë-së fundore.

§ 7. Në disa të folme të gegërishtes jugore dhe në të folmet gege më veriore shpesh reduktohet gjer në zero ë-ja në rrokje fundore të mbyllur; si rezultat zanorja e theksuar nuk dëgjohet më si zanore e gjatësisë së mesme si zakonisht, por dëgjohet herë e gjatë, herë e shkurtër. Format pa ë i kemi takuar në Ndroq, Shijak, Maminas, Ishëm, Dajt, dmth. në grupin e të folmeve gege jugore-perëndimore: *di:ts* (Nd.K.), *Kodre Sa:ls* (D.Pr.M.), *Ko:ls* (Sh.S.), *dri:ts* (Ma.R.), *pu:ns* (I.), *Qu:ks* (I.); në të folmet gege më veriore ky fenomen është edhe më i shpeshtë; format me ë-në e temës dëgjohej më rrallë: *lo:ps*, *pa:ts*, *rru:gs*, *bo:ts* (Zerqan, Peladhi). Në Ishëm, Shkodër etj. zanorja e theksuar e këtyre fjalëve, pas reduktimit të ë-së është mjaft herë e shkurtër: *pats* (I.), *friks* (I.), *rrugs* (I.); *fjals* (Shkodër), *pëlhurs* (Shkod.), *lops* (Shkod.). Të shkurtëra dëgjohej zanoret e theksuara të këtij pozicioni sidomos në Shkodër e në ndonjë të folme tjetër të ekstremit verior.

Pra zanorja e theksuar në emrat e gjinisë femërore të rasës gjindore, dhanore e rrjedhore të kësaj forme mund të jetë e gjatësisë së mesme (*lo.pës*), e gjatë (*lo:ps*), e shkurtër (*lops*). Edhe këtu kemi

32) M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të poshtëm*, «Stud. Filol.», 1, 1964, 134.

gjatësi kompensatore të përftuar besoj nga rënja e ë-së fundore të temës, gjatësi e cila shumë-herë ruhet edhe gjatë fleksionit në rasat e zhdrejta.

Si në Veri ashtu edhe në të folmet toske jugore, emrat femërorë të tipit *dhi*, në rasat e zhdrejta njëjës trajtë e shquar e ruajnë gjatësinë (*dhi:s*, *dhi:n*), (kujto emrat mashkullorë që e ruajnë gjatësinë vetëm në kallëzore (*shi:n*)).

#### *Format e së ashtuquajturës «rasë vendore».*

§ 8. Në këtë formë gramatikore zanorja e theksuar, siç e tregon materiali, është e gjatësisë së mesme sa herë që ë-ja fundore e temës ruhet. Përkundrazi, kur ajo reduktohet atëhere zanorja e theksuar është e gjatë ose e shkurtër. Ndërsa gjatësia takohet rëndom, shkurtësia më rrallë: nër *çi:kt* (T.Mëz.), *m'gro:pt* (T.M.), *m'fe:rrt* (T.M.), *m'na:pt* (Herraj), *n'hu:rdht* (Herraj), *m'ta:vt* (Sh.Sh.), përmi *to:kt* (J.), për *va:pt* (Ma.R.).

Edhe në këtë rast kemi gjatësi kompensatore të përftuar me rënjen e ë-së fundore, e cila ruhet edhe në rrokje të mbyllur. Besojmë kështu sepse gjatësi vihet re edhe në «vendoren» e emrave mashkullorë kur zanorja ruan një gjatësi tjetër (jo kompensatore), megjithëse del në rrokje të mbyllur: *m'hara:rt* (Herraj), *m'gashta:rt* (P.), dahet me *bu:rrt* (Pre.). Gjithashtu në formën e «vendores», në shumicën e rasteve, ruhet si e tillë edhe zanorja e theksuar e gjatë fund fjale: me *shpi:t* (Sh.Z.), për *shi:t* (Elbasan) etj., Por, megjithatë ka raste të rralla kur pas reduktimit të ë-së së temës, zanorja e theksuar dëgjohet e shkurtër: *n'rrukt* (I.), me ert tranafililit (Gj.), *n'trînt* (K.Q.), *m'ka çu: çuni për goct* (Kërrabë).

Në të folmet toske që njohin «vendoren» si edhe në disa të folme kalimtare emrat femërorë e mashkullorë, që sosin me zanore të theksuar të shkurtër, e ruajnë shkurtësinë edhe në këtë formë: me *kat*, nëpër *shit* (Berat), *n'kusit* (V. Sh.), *m'xhamit* (V. Sh.), *n'kusit* (V. Sh.).

Në dialektin e Veriut gjatësia e shkurtësia e rrokjes së hapur në fund të fjalës ruhet pothuajse rregullisht në vendore: i kam *dha:n* mesollen teme për *vlla:t* t'atij (Kërrabë), po erth njeri për *ka:t* (Kërrabë), ta shtite xhinazen *n'dhe:t* (Peqin), etj., ose ruhet shkurtësia: qan për *qît* (= qingjin, Kërrabë).

Kuptohet se shkurtësia e emrave mashkullorë, që sosin me bashkëtingëllore ruhet rregullisht në formën e vendores: *n'shesht*, *m'shkamt*, *n'malt* (Kërrabë), *n'topt*, *n'hant*, me *kllicjt* etj.

#### *Format e shumësit të emrave mashkullorë e femërorë në të dy trajtat, rasa emërore*

§ 9. Emrat mashkullorë, që dalin në temë me bashkëtingëllore dhe që e formojnë shumësin me -ë, në numrin njëjës e kanë përgjithësisht zanoren e theksuar të shkurtër. Ndërsa në format e shumësit zanorja i ka të tria shkallët e gjatësisë e kjo sipas të folmeve të ndryshme të shqipes.

Në dialektin e Veriut, në shumicën e të folmeve, pas reduktimit të plotë të mbaresës së shumësit -ë, zanorja e theksuar ka kaluar nga

një zanore e shkurtër në një zanore të gjatë. Ne kemi në dorë rreth 100 emra të cilët tregojnë frymorë e jofrymorë dhe që sot në gegërishte e formojnë shumësin vetëm me zgjatim kompensator. Bashkëtingëlloret që mbyllin temën e emrave mund të jenë të ndryshme, por më shumë bien në sy sidomos emrat, që sosin në temë me *-k*. Po japim, në radhë të parë, disa nga emrat që dalin në temë me *-k* (njëjës dhe shumës): *xhelek* > *xhele:k*, *dyshek* > *dyshe:k*, *qerek* > *qere:k*, *qerpik* > *qerpi:k* (T. Mëz.), *butuk* > *butu:k*, *rosak* > *rosa:k*, *jestik* > *jesti:k*, *dajak* > *daja:k* (T.M.), *bardhak* > *bardha:k*, *çubuk* > *çubu:k* (T.S.), *dyfek* > *dyfe:k*, *axhak* > *axha:k*, *calik* > *cali:k*, *çekrik* > *çekri:k*, *qukapik* > *qukapi:k* (Herraj), *çuplak* > *çupla:k* (Ç.L.), *çuruk* > *çuru:k*, *rrollak* > *rrolla:k* (Ç.Lu), *ftujak* > *ftuja:k* (Rr. D.Q.), *koshak* > *kosha:k* (P.Vr.), *çibuk* > *çibu:k* (Krr. V.), *jebrik* > *jebri:k* (D.Q.), *gushak* > *gusha:k* (Ç.K.), *çakmak* > *çakma:k* (P.M.), *qerpak* > *qerpa:k* (P.M.), *shnik* > *shni:k* (Sh. S.), *fishek* > *fishe:k* (J.), *kavak* > *kava:k* (Pre.), *synyk* > *syny:k* (Ma.R.), *çekrik* > *çekri:k* (Ma.).

Ja edhe disa emra që dalin në temë me bashkëtingëllore tjetër: *vesh* > *ve:sh*, *uriq* > *uri:q*, *saç* > *sa:ç*, *urith* > *uri:th*, *dallap* > *dalla:p*, *kapuç* > *kapu:ç* (T. Mëz.), *karcalec* > *karcale:c*, *katec* > *kate:c* (T.M.), *rrallos* > *rrallo:sh*, *carac* > *cara:c* (Herraj), *hajat* > *haja:t* (Ç.Lu.), *hamall* > *hama:ll* (Kërrabë), *kaçup* > *kaçu:p* (D.B.), *kathec* > *kathe:c* (Nd.K.), *rrallos* > *rrallo:sh* (Nd.K.), *kavall* > *kava:ll* (Ndr.), *patog* > *pato:g*, (P., Sh., T. Mëz.), *satac* > *sata:c* (Ma.R.), *reshil* > *reshi:l* (Ma.), *çyrjep* > *çyrje:p* (D. Pr.M.).

Në Shkodër zanorja e theksuar e emrave me temë me *-k* është e gjatësisë së mesme, ose më e gjatë se e mesmja, por jo aq e gjatë sa në shumicën e të folmeve gege (megjithate, meqenëse i afrohet gjatësisë, po i japim me shenjën e gjatësisë): *jelek* > *jele:k*, *shoq(k)* > *sho:k*, *qerpik* > *qerpi:k*, *axhak* > *axha:k*, *vorcak* > *vorca:k*. Më e shkurtër na është dukur gjatësia në këta emra: *dajak* > *daja:k*, *dyshek* > *dyshe:k*, *fushek* > *fushe:k*. Të njëjtën gjatësi vërejmë edhe tek emrat që sosin në temë me tjetër bashkëtingëllore: *shkadrâ:n*, *dha:m*, *kulac* > *kula:ç* etj.

Në të folmet kalimtare zanorja e theksuar e emrave mashkullorë, që sosin me bashkëtingëllore të ndryshme, ka të njëjtin kuantitet sikurse në shumicën e të folmeve gege: *fishe:k*, *kona:k*, (Sh. Z.), *dysh:k*, *qupe:k*, *guha:k* (Sh. Gj.), *lele:k* (D.Gj.), *bardha:k*, *dyfe:k*, *hajva:n*, *iri:q* (V.Sh.), *jata:k*, *hama:ll*, *kapo:sh* (V.S.), (krahaso format e njëjësit *fishek*, *konak*, *dyshek*, etj.).

Tek emrat mashkullorë, zanorja e theksuar e të cilëve ndiqet nga një *-r* fundore, gjendja nuk paraqitet e njëjtë me emrat e tipit të mësipërm. Në shumicën e të folmeve gege zanorja e theksuar e emrave të këtij tipi është e gjatë si në njëjës ashtu edhe në shumës, dmth. forma e njëjësit nuk dallohet nga shumësi (mbaresa ë e shumësit e ndodhur në pozicion fundor gjithashtu është reduktuar plotësisht). Ky fakt dëshmon se gjatësia e zanores në këtë rast nuk është gjatësi kompensatore e përftuar nga rënja e ë-së fundore, por gjatësi e përftuar nga natyra e tingullit që e pason atë, pikërisht nga *-r*-ja; të tilla janë gjatësitë në emrat që pasojnë: *ushta:r*, *beqa:r*, *gu:r*, *zinxhi:r* (Elbasan), *ushta:r*, *lita:r* (T. Mëz.), *gu:r*, *ushta:r* (T.M.), *gamo:r* (Herraj), *mulla:r*, *shqipta:r*, *lita:r* (Ç. Zg.), *hama:r*, *mu:r*, *gu:r* (Ç.L.), *mulla:r* (D.Q.), *tina:r* (M.), *buli:r* (M.), *lita:r* (M.), *maxha:r* (L.P.), *bu-*

*lla:r* (P.M.), *gu:r* (P.), *mulla:r* (Sh.S.), *kulma:r* (Sh.S.), *ushta:r*, *lta:r*, *mlla:r* (Ma., Ma.R.), *gashta:r* (D.Pr.M.), *dama:r* (Z.H.).

Rrallë dëgjohen te disa të folme gege zanore të theksuara të shkurtëra në format e njëjësit: *fishnjar* (Elbasan, Ç.L. etj.), *meçkar* (Ç.L.), *skifter* (Sh.Q.).

Në disa të folme të tjera gege, e pikërisht në të folmet e gegërishtes veriore, si në Shkodër, Shkrel, Pukë etj. vërehet një dukuri karakteristike në kuantitetin e zanoreve të theksuara të emrave më-*r*. Kështu në të folmen e Shkodrës gjenden zanore të gjata në format e njëjësit te këta emra: *gu:r*, *y:r* (=urith), *ushta:r*, *kula:r*, *buqa:r* (=bujku), *beqa:r*, *katunda:r*, *gama:r*, *qyteta:r*, *qese:r* (=sqopar), *mulla:r*. Në format e shumësit zanorja e theksuar, në pjesën më të madhe të këtyre emrave e në dallim nga shumica e të folmeve gege, e humb gjatësinë dhe kalon në shkurtësi: *gur*, *yr*, *kular*, *beqar*, *goamar*, *qeser*, *mullar*. Ndër të tjerë, nuk e humbin gjatësinë në shumës, dmth. dalin njëjloj si në njëjës ashtu edhe në shumës emrat: *ushta:r*, *buqa:r*, *qyteta:r*. Ndonjë emër dëgjoher herë me zanore të gjatë, herë me zanore të shkurtër në shumës: *katunda:r*, *katundar*. Me zanore të shkurtër dëgjohen edhe shumësat *plor*, *mushkor*, që dalin me zanore të temës të ndërruar (njëjës: *plu:r*, *mushku:r*). I njëjti fenomen shfaqet edhe në të folme të tjera të Veriut, p.sh. në Shkrel: *gu:r* (nj.) > *gur* (sh.), *goma:r* (nj.) > *gomar* (sh.), *flamu:r* (nj.) > *flamur* (sh.). Këto të folme të Veriut përdorin pra si tregues të shumësit shkurtimin e zanores së gjatë të njëjësit.

Në të folmet kalimtare dëgjohen zanore të gjata në njëjës e në shumës: *goma:r*, *pena:r*, *ushta:r* (Shpat), *ushta:r*, *goma:r*, *bulla:r*, (V. Sh.). Në emrat e këtij tipi në një pjesë të Vërçës (pjesërisht në Shënepremte dhe rregullisht në Snosëm, Poroçan i Zi etj.) vërehen dallime. Në Shënepremte në format e njëjësit vihet re disa herë edhe gjatësi e mesme: *mulla:r* (nj.) > *mulla:r* (sh.), ndërsa në Snosëm shkurtësi në format e njëjësit dhe gjatësi në shumës: *gomar* (nj.) > *goma:r* (sh.), *ushtar* (nj.) > *ushta:r* (sh.), *sqyfer* (nj.) > *sqyfe:r* (sh.), *gur* (nj.) > *gu:r* (sh), *gomar* (nj.) > *goma:r* (Poroçan i Zi). Gjatësia në format e shumësit tek emrat e këtij tipi është gjatësi kompensatore.

Në dialektin e Jugut vihen re që të tria shkallët e kuantitetit për zanoret e theksuara të emrave mashkullorë me temë në bashkëtingëllore në numrin shumës.

Gjatësia e mesme vërehet kryesisht kur mbaresa -ë ruhet plotësisht ose reduktohet deri në një farë mase: *byzyly.k(ë)*, *gjyzyly.k(ë)*, *sho.k(ë)* (Korçë).

Në këto raste format e njëjësit dallohen nga format e shumësit (të parat kanë zanore të shkurtëra, të dytat zanore të mesme dhe një ë të reduktuar mjaft në fund; njëjës: *byzylyk*, shumës: *byzyly.k(ë)*).

Shkurtësi vërehet kur mbaresa -ë e shumësit reduktohet në zero; në këtë rast format e njëjësit e të shumësit janë identike: *jelek*, *çibuk*, *biçak*, *dybek*, *koçek*, *fishek*, *dyshek*, *shok*, *bardhak* (Vlorë).

Gjatësi vërehet në disa të folme toske të ekstremit jugor. Kështu p.sh. në Kuç kemi dëgjuar zanore afër të gjatës: *sho:k*, *shele:g*, në Volë: *dishe:k* (më e gjatë se e mesmja), por *jastek*.

Emrat me temë më -*r* e kanë zanoren e theksuar të shkurtër (afër

së mesmes) në Korçë e në Vlorë *gomar, lopçar, fener, yzmeqar*, në shumës afron më tepër nga e mesmja. Në Vlorë: *gomar, gur, bullar, qytetar, fshatar, samar*. Në Kuç kemi gjatësi në format e njëjësit dhe të shumësit: *ushta:r, goma:r, mu:r, qiteta:r, fshata:r*; po kështu edhe në Volë: *ushta:r, gu:r, mulla:r, goma:r*.

§ 10. Në trajtën e shquar shumë emrat mashkullorë që dalin në temë me bashkëtingëllore, e kanë zanoren (në të folmet e ndryshme të shqipes) të gjatë, të mesme ose të shkurtër).

Gjatësia ruhet në shumicën dërmuese të rasteve kur mbaresa -ë e shumës nuk del në trajtën e shquar. Po japim këtu, sipas të folmeve, shumë nga shembujt që kemi takuar: *kava:llt* (T. Miz.), *malo:kt, za:rt, kula:rt* (T.M.), *dishe:kt, flo:kt, kula:rt* (Herraj), *dalla:pt* (Ç.L.), *malo:kt, dha:mt, gu:rt, kula:rt, sho:kt* (Nd.K.), *ske:pt* (P.M.), *gu:rt, kupa:ct, qerpi:kt, pato:kt, karcale:ct, butu:kt, hara:rt* (P.), *xhele:kt, gu:rt, za:rt, qerpi:kt* (Sh.Q.), *fjo:kt, kula:rt, dha:mt, za:rt* (J.), *za:rt, kula:rt* (Pre.), *dalla:pt, kate:ct, lta:rt, kula:rt, sho:kt* (Ma.R.), *xhele:kt, çekri:kt, bardha:kt, kate:ct* (Ma.), *zhele:kt, axha:kt, fshe:kt* (D.Pr.M.), *za:rt, hara:rt, bërda:kt, dama:rt, axha:kt* (Z.H.), *ske:pt, gu:rt* (K.K.), *roca:kt* (K. Kr.), *çerje:pt* (Sh.).

Në të folmet kalimtare ruhet gjithashtu gjatësia: *ca:kt* (Sh.Z.), *shpatara:kt, shallva:rt, qype:kt* (Sh.Gj), *maço:kt* (V.Sh.), *iri:qt* (V.S.).

Në Shkodër përgjithësisht ruhet ajo shkallë e kuantitetit që ka zanorja e trajtës së pashquar shumë: *sho:k > sho:kt, axha:k > axha:kt, ushta:r > ushta:rt, buqa:r > buqa:rt, gjyteta:r > gjyteta:rt*; nga ana tjetër: *kular > kulart, gur > gurt, qeser > qesert, mullar > mullart, beqar > beqart, gamar > gamart*, po kështu *mushkort, plort*.

Në trajtën e shquar shumë, shkurtësia takohet në të folmet e Veriut më rrallë: *gjermant* (T.S., J.), *partizant* (T.S.), *këlysh* (Ç. Zg.), *hajvant* (L.F.), *këlysh* (Ç.K.), *katolikt* (Sh.S.), *gomart* (I), *teftert* (K. Q.); më dendur në të folmet e Jugut: *pronart* (Korçë), *muhaxhirt* (Vlorë) etj.

§ 11. Pak a shumë po në këtë gjendje paraqitet kuantiteti i zanores së theksuar në shumësin e emrave femërorë trajtë e shquar (paralelizmi është tipik sidomos tek emrat femërorë, që dalin në temë më -ë, e cila fonetiki është e barabartë me mbaresën -ë të shumësit të mashkullorët); gjatësi: *pu:nt* (L.D.), *gro:sht* (Sh. Gj), *shka:llt* (D.Pr. M.), *dâ:nt* (Z.H.), *lo:pt* (Z.H. Sh. Sh.), *zo:rrt* (Sh.S.), *bu:kt* (Sh.S.); shkurtësi: *zorrt* (I.B.), *punt* (K.Q.), *qept* (Shpat), *grest* (Shpat), *lopt* (K. Q.), *pent* (K. Rr. G.), *kômt* (K.Kr.).

Emrat mashkullorë e femërorë, që sosin në temë me zanore të theksuar, në trajtën e shquar ruajnë përgjithësisht shkallën e kuantitetit që ka zanorja në rrokje të hapur fund fjale të trajtës së pashquar: *gra: > gra:t, shtëpi: > shtëpi:t, sy: > sy:t* (Elbasan); përgjithësisht kjo vihet re në të gjithë dialektin e Veriut: tek *fmit* (Ç.Zg., Ç.F., Ç.L.), ruhet kuantiteti i trajtës së pashquar *fmi* (krahaso *fmi:t* në Elb., Sh. Sht., Sh. Sh.).

Në dialektin e Jugut zakonisht zanorja e theksuar e këtyre emrave dëgjohet e shkurtër (ruhet kuantiteti i trajtës së pashquar), në ato të folme toske që nuk e njohin shkallën e gjatësisë, dhe dëgjohet e gjatë (ruhet kuantiteti i trajtës së pashquar) në ato të folme toske të ekstremmit jugor që e kanë gjatësinë: *shtëpi > shtëpit, qe > qet, dru > drut, sy > syt* (Vlorë), *ve: > ve:t, tru: > tru:t, si: > si:t, gra: > gra:t* (Kuç).

*Format e shumësit me metafoini të disa emrave mashkullorë*

§ 12. Gjatësi ose shkurtësi mund të ketë zanorja e theksuar edhe në format e shumësit me metafoini. Në shumicën e të folmeve të shqipes mbizotëron trajta me zanore të shkurtër. Kjo vihet re në shumicën e të folmeve gege dhe në të folmet toske; po rrjeshtojmë shembujt pa ubikacionet përkatëse, me përjashtim të ndonjë rasti kur ka variante fonetike të ndryshme në të folmet e ndryshme të shqipes: *dash* > *desh*, *dac* > *dec*, *gugash* > *gugesh*, *shjarth* > *shjerth*, *mëzat* > *mëzet*, *saç* > *seç*, *cap*, Elb., Ç.Zg., Çermënikë, Rr. Krr.V., Vlorë, Kërçukje, P.M., Ma.R. (*sjap* T.M., Herraaj, Sh.S., Sh. Sh., Ma.R.; *sqap*, Ç.Lu., Sh.Z., Shkodër; *cjap*, Kuç, Volë) > *cep*, T. Mëz., Ç.L., Nd.K.; P., P.M., (*sjep*, T.M., T.S., Herraaj, Shkodër), (*sqep* Ç.Lu. P.), (*cjep*, Vlorë, Kuç, Volë), (*sjep*, P.M., Ndr., Sh. Sh., Sh.S., I.B., Pre., Ma.R., D. Pr. M., Sh., Sh. Q.).

Në rastet që dhamë, shkurtësisë së njëjësit (*dash*) i përgjigjet shkurtësi në shumës (*desh*). Por ka të folme *gege* ku dëgjohet zanore e gjatë në shumës: *dash* > *de:sh*, *cap* > *ce:p* (Elbasan), *guge:sh* (Nd.K., Herraaj, Z.H., K.Q., K.Kr.); në T.M. përdoren që të dy format *gugesh* e *guge:sh*; *sqe:p*, *ce:p* (Sh.Z., K.Q.), *ce:p* (Sh.Gj.), *sqe:p* (Sh.Tr., D. P.Th., *cje:p* (V.Sh.), *ce:p* (Krr.V., K.Kr.), *de:sh* (V.S., D.P.B., V.Sh., D.P.Th., Durrës, K.Q., K.Kr.), *de:c* (Sh.), *kule:ç* (P.Vr.), *rece:k* (K.K.). Edhe në Kuç krahas *desh* kemi dëgjuar *de:sh*, por në trajtën e shquar vetëm *desht*.

Tipari kryesor i shumësit të këtyre emrave është metafoina, ndërsa gjatësia është tipar suplementar, për mendimin tonë, ajo është gjatësi analogjike sipas gjatësisë kompensatore të shumësive të tipit *dyshe:k*, *lejle:k*, *jele:k* etj.

*Format foljore të kohës së tashme të mënyrës dëftore*

§ 13. Disa folje të zgjedhimit të tretë, disa folje të parregullta e ndonjë tjetër në formën e vetës së tretë njëjës e kanë zanoren e theksuar të gjatë ose të shkurtër. Kështu p.sh. e folmja e Elbasanit i shqipton këto forma me zanore të gjatë: *hiñëlli:n*, *shkrepti:n*, *bubulli:n*, *fërshëlli:n*, *ça:n*, *ma:n* (mban), *ble:n*, *ni:n* (=dëgjon), *fry:n*, *ne:n*, *me:n*, *tha:n*.

Por në gegërishte jugore-perëndimore, në disa të folme gege më veriore si dhe në disa të folme toske, zanorja e theksuar e këtyre formave është e shkurtër: *hiñëllin* (T.S., K.Kr. P.M., P., *hiñllin* Sh.Sh., *hiñllein* I.), *shkreptin* (T., P., Çermënikë-Neshtë, *shkaptin* (Kavajë, *shkreptin* P., *shkaptin* — I.), *vëshllen* (T., Nesht-Çerm.), *man* (Sh.Q.I., Ma.R., Ç. Zg.), *çan* (Durrës), *çan* (Vlorë) etj. Disa folje të zgjedhimit të tretë në të folmen e Elbasanit dalin në njëjës pa mbaresën *-n* dhe zanoren e kanë të gjatë: (ai) *ha:*, *rri:*, *pi:* (në të tria vetat), ndërsa në të folme të tjera gege dalin në vetën II e III njëjës me mbaresë dhe me zanore të shkurtër: (ai) *han* (T.S., T.M., Shkodër, Pre., D.B., Nd. K., D. Pr., M., Kavajë), *rrin* (T.S., Shkodër), *pin* (Durrës, Shkodër, Nd. K.), etj.

Zanoret e theksuara të foljeve me temë më *-ll*, *-l*, kohë e tashme njëjës, dalin të gjata ose të shkurtëra: në të folmen e Elbasanit kemi

gjatësi: *mje:ll, vje:ll, vje:l, mje:l*, ndërsa në të folme të tjera gege dhe në të folme kalimtare kemi shkurtësi: *mjell, vjell* (Peladhi, Peshkopi), *vjel* (Ç.Zg., Durrës, V.S.), *mjel* (Durrës, V. Sh.).

Në format e kohës së tashme për foljet e zgjedhimit të tretë e të katërt, veta I dhe III shumëz zanorja e theksuar në disa të folme është e gjatë, në disa të tjera e shkurtër, ndër këto mbizotëron trajta me zanore të shkurtër. Zanore të gjatë gjejmë në Elbasan, Grykë Zaranike, në një pjesë e Kërrabës; gjatësi takohen gjithashtu në Martanesh, Çermënikë, Dumre. Po japim disa shembuj: I *puno:im, qëro:im, beso:im, kërkoi:im, ble:im, ve:im, ha:m (ha:im)*; III *kullo:in, rrfe:in, ble:in, ha:n, (ha:in)* etj.

Në krahinat e Tiranës (Ndroq, Pezë, Prezë, Zall Herr, Shingjergj, Dajt, Petrelë), në Durrës (Rrogoshinë, Kavajë, Shijak, Ishëm, Maminas), në Peqin, në Zerqan (Peladhi), në Shkodër, në Vlorë, në Korçë etj. ne kemi takuar në këto forma rregullisht zanore të shkurtëra: I *capojm, kashtojm, qarkojm, punojm, zblojm, kërcejm, kthejm, zhgojm, hajm*; III *kënojm, qënroj, rroj, rrfej, mërthejm, dëftejm, vjn*. Në Shkodër kemi dëgjuar: *minojm, shlojm, latojm*, por më rrallë: *puno:im, puno:in*; në Korçë: *qëndrojm, trazojm; qëndrojm, lëvdojm*; në Vlorë: *zjejm, lëftojm; lëftojn, lërojm*. Në disa raste edhe në foljet që kanë të theksuar një zanore të përftuar, si rezultat të monoftongimit të një diftongu, prapë takohet shkurtësi: *gatujm, shkrujm*.

Natyrisht, trajtat me zanore të shkurtër ruhen në të njëjtat veta edhe në format analitike të lidhore e të ardhshmes: *t'punojm, t'kënojm, t'çmojm; do ta qëroj, do e çojm, do i zhgojm, do rroj, do haj, do pijn*.

#### Format foljore të së kryerës së thjeshtë

§ 14. Gjatësi gjejmë në disa forma arkaike që ruhen ende sot; ndodh shpesh që mbaresa vetore të asimilohet me bashkëtingëlloren fundore të temës. Në këto forma gjatësinë e ruajnë edhe zanoret e përfthuara me monoftongimin e -ue-së: *du:lm* (krahaso gjatësinë e mesme në formën *du:lën*, shih § 18.); *mo:ilm* (Krr.V.), u *pra:llm* (M.), *fu:m* (Kuç); *du:lt* (Elbas.), *hy:pt* (Krr.V.); *mu:rn, du:ln* (T.M.), *qe:ln* (Ç.Zg.), *mu:lln* (Ç.L.), *me:n* (Gr.Z.M., Krr. D.P. Th.), *fu:n* (Rr.K.), *kpu:n* (Sh.Gj), *hy:pn* (Sh. Tr.), u *këpu:n* (Kuç), *mbe:n* (V.Sh.), *hi:kn, rro:kn* (Krr.V.).

Gjatësi vërehet edhe në foljet e parregullta e supletive: *pa:m* (patëm, Rr.K.), *pa:n* (patën, Dumre), *qe:m, qe:n, tha:m, tha:n* (përgjithësisht në gegërishte). Por nuk janë të rralla trajtat me zanore të shkurtër: *pam* (=patëm, Vlorë), *pam* hek keç (L.F.), *pan* pas (Sh.Gj), *qem* (Krr. Gr., Nd.K.), *qen* (K.Kr., Rr. K.), *tham* (I.), *dhan* (I.).

Po të krahasohen për nga shkalla e përdorimit *hy:pn, hypn* rezulton kjo: më shpesh takohet shkurtësi; shkurtësi në këto raste gjejmë në gegërishte e në toskërishte, madje në të njëjtën të folme mund të gjenden njëherazi forma me të dyja shkallët e kuantitetit: p.sh. në T.M. gjejmë *vdinqn, faln, hoqn, u farisn*, por edhe *hi:kn*; kjo dëshmon se e folmja jeton në fazën e rrafshimit të shkallës së gjatësisë dhe se rruga e evolimit të kuantitetit në forma të tilla është kjo: *hiknë > hi:kn > hikn*. Nuk të lejon ta shohësh *hi:kn* si trajtë më të re nga *hikn*, ndër të tjera, edhe shkurtësia tek *duln* (që ta-

kohet sot p.sh. në T.S.), zanorja e së cilës, siç dihet, vjen nga një *u*: (<*ue*).

Po japim disa shembuj nga të folmet e ndryshme ku vërehet shkurtësia: *fjetm*, *duln*, *hikn*, *u lodhm* (T.S.), *gjetm* (Sh.Q.), *u doqn* (Sh.Sh.), *u vran* (Neshtë, Çerm.), *erthm* (Kuç), *krisn* (Korçë), *u lakn* (Korçë), *vdijn* (Vlorë) etj.

Në format e aoristit sigmatik vërehen zakonisht zanore të gjata dhe të shkurtëra. Foljet e parregullta e supletive dalin të gjata: *dha:sh*, *pa:sh*, *qe:sh*, *tha:sh* (Elbasan), *pa:sh*, *dha:sh* (T.Mëz), *pa:sh* (Herraj, Ç.L., Ç. Lu., K. Kr.), *qe:sh* (Shpat, T.M.); *qe:ç*, *tha:ç*, *pa:ç* (Shkodër), *tha:sh* (Çermenikë, Sh. Tr.); por shpesh të këto forma kemi takuar zanore të shkurtër: *thash* (T.Mëz., F.K., P., Dumre-Bel.), *thash* (Korçë), *qesh* (T.Mëz., Rr.K., P., Ma. R., D. Pr. M., Vlorë; në Vlorë pak më e gjatë se e shkurtëra e zakonshme); *paç* (Elbasan, Dumre, Ndroq, Pezë etj.).

Të gjata dalin në Veri zanoret në format pësore për foljet më zanore: *u la:sh*, *u zotu:sh*, *u shkru:sh*, *u gëzu:sh*, *u kru:sh*, *u zu:sh*, *u da:sh*, por *u qaç* (V.Sh.); të shkurtëra dhe të mesme në format pësore për foljet me bashkëtingëllore: *u lothsh*, *u lithsh*, *u poqsh*, *u doqsh*, *u plaksh* (por *u tremësh*, *u kapësh* etj.). Trajtat me zanore të shkurtër janë më të rëndomta.

#### Format e pjesores

§ 15. Gjatësia vihet re në gegërishte në disa raste kur pjesoret dalin pa mbaresë, si edhe me mbaresën *n* (ë) në foljet e parregullta dhe në gjysëm të rregullta.

Le të shohim, në radhë të parë, foljet e parregullta e gjysëm të rregullta. Në Tropojë (Krasniqe, Gash e Bytyç) ato dalin të gjata: *tha:on*, *ra:on*, *ka:on*<sup>33</sup>. Të gjata janë zanoret e foljeve në mbaresën *-n* (ë) edhe në të folmen e Nikaj-Mërturit: *dha:on*, *ka:on*, *tha:on*, *za:on*<sup>34</sup>. Në Elbasan, Martanesh, Çermenikë e në të folmet kalimtare shumica e tyre janë të gjata, po kështu, me përjashtime të rralla edhe në të folmet e Tiranës, Durrësit: kam *qe:n*, ka *tha:n*, kam *a:rdh*, ka *ra:n* (Elbasan), *a:rdh* (T.M., T. Mëz., Ç.L., Sh.Z., Sh.Tr.), *qe:n* (T.M., T.S., Shpat, Peqin, Durrës, Pezë, Shijak, Ishëm). Por rrallë herë zanorja e theksuar e kësaj folje është dëgjuar e shkurtër: ka *qen* (Rr.K), ka *qên* (P.M.). Folja *me ranë* në shumicën e të folmeve gege del pa mbaresën *-n* (ë) dhe zanorja e theksuar është gojore edhe e gjatë (kan *ra:*). Foljet e parregullta e supletive në të folmen e Shkodrës në pjesore e kanë zanoren e theksuar përgjithësisht të gjatë: jan *ke:n*, kan *a:rdh*, kishte *ra:*. E gjatë del zanorja e këtyre formave edhe në ndonjë të folme toske që e njih gjatësinë, kështu p.sh. në Kuç dëgjohen: kan *pa:r*, kan *që:n* etj. Por në Vlorë është e shkurtër: ka *qen* etj.

Format e pjesores së foljeve me bashkëtingëllore në dialektin e Veriut e kanë zanoren e theksuar të shkurtër ose të gjatë, megjithëse ë-ja fundore e tyre ka rënë rregullisht. Kjo varet nga lloji i foljeve

33) J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, Bulet. i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 4, 1963; 18:

34) E: Lafe, *E folmja e Nikaj Mërturit*, Stud. Filologjike, 3, 1964:

dhe nga vetë të folmet e ndryshme. Foljet më bashktingëllore, pjesorja e të cilave ka pasur mbaresën ë, kanë pësuar zgjatim kompensator dhe e ruajnë këtë zgjatim pothuajse rregullisht në të folmen e Nikaj-Mërturit: *dje:g, dje:rg, li:dh, ma:rr, mbje:ll, mbu:sh, nda:l, so:s, llomi:t, pja:s, pve:t, qi:t, vllasi:t*»<sup>35</sup>. Gjatësia kompensatore ruhet sot në shumicën e të folmeve gege dhe në të folmet kalimtare kryesisht te pjesoret e foljeve që u mbaron tema më *l, ll, r, rr*: (kan) *da:l, ka ma:rr, kan mje:ll, ka va:r, jan tu:rr* (Elbasan), *da:l, çe:l* (T.S.), *fo:l, da:l* (Ç.Zg.), *da:l* (Ç.L.), *my:ll* (Rr.K.), *vje:l* (Sh.Tr.), *da:l* (Sh. Sht.), *da:l* (T.M., Durrës, Martanesh), *mje:ll* (I.), *my:ll* (T. Mëz.), *da:l, ma:rr, mje:ll, mshtje:ll, pje:ll, shte:r, va:r* (Dumre), kam *thi:rr* (V.P.P.). Në Shkodër gjithashtu foljet e këtij tipi dalin zakonisht me zanore të gjatë: ka *pje:ll, ka da:l, ash ç:i:l, ka përcje:ll*.

Por në shumë të folme gege, duke përfshirë këtu edhe ato më veriorët, vihen re kalime të gjatësisë në shkurtësi, madje edhe në foljet më *l, ll, r, rr*: kan *thirr* (T. Mëz., Ç. Lu.), *fol* (T.M.), ka *fal, ka shterr* (Shkodër), kan *çel* (Ç.K.), kam *myll* (Nd. K.), jan *përvjel* (Sh. Sh.), ka *thur* (K.Q.), jena *turr* (Ishëm). Ndryshe qëndron puna tek pjesoret e foljeve që dalin në temë më bashkëtingëllore të tjera: në shumicën dërmuese të rasteve zanorja e theksuar e pjesoreve në trajtat e përbëra të foljeve nuk e ruan gjatësinë dhe dëgjohet e shkurtër. Kjo është karakteristike jo vetëm për të folmet gege e kalimtare, por edhe për disa të folme toske: (ka) *hek, fut, lyp, prish, hum, plagos, nrof, vjeth* (Elbasan, Kavajë, Durrës), ka *ik, kam huth, duhet qep, kan gjesdis, ke prish, i kishte gris, e ma lith, kam mleth* (Kërrabë), *nref, vdek, thir, mleth, nrys* (Peqin), ka *vesh, ka vdek, kap* (T. Mëz.), *pjek* (T.S.), kishte *fut* (Sh.Tr.), kan *dek* (L.F.), ka *met* (Ç.K.), ka *gjet* (P.), ishte *prish* (Sh.Q.); në Shkodër gjithashtu: kam *myt, kan shit, asht majt, ka lyp*. Por në një numër të kufizuar rastesh zanoret e theksuara të pjesoreve të këtyre foljeve e ruajnë gjatësinë kompensatore; më shpesh ato takohen në të folmet gege veriore: ka *de:k, gje:t, ka hu:p* (Shkodër), jan *mle:dh* (L.G.), (me) *li:th, (me) vje:th* (Mat)<sup>36</sup>.

Gjendja e kuantitetit të zanoreve të theksuara te pjesoret e foljeve më bashkëtingëllore, siç duket nga materiali, është e pakristalizuar; në këtë pikë ka lëkundje të theksuar, por sidoqoftë ne kemi takuar shkurtësi në një numër mjaft të madh pjesorësh të tilla. Prandaj as për gegërishten nuk na duket i mbështetur në fakte pohimi se «gjatësia është tipar i pandashëm i disa formave, siç është pjesorja e infinitivi i foljeve...»<sup>37</sup>.

### Forma e ndonjë ndajfoljeje

§ 16. Ndajfolja e kohës *kurrë* në dialektin e Veriut del pa ë fundore dhe me kuantitet të ndryshëm të zanores së theksuar. Rregullisht ka zanore të gjatë në Tiranë (Mënik, Herraj, Petrelë, Grykë Zaranike, Elbasan, Çermënikë, Kavajë etj.; gjithashtu në të folmet kalimtare (*ku:rr*). Rregullisht kemi zanore të shkurtër (*kurr*) në të

35) E. Lafe, *Po aty*.

36) B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, Nr. 2, 1962; 241.

37) A: Dodi, *Dispensë e cituar*, 76.

folmet gege veriore (Shkodër, Ishëm, Maminas, Nikaj-Mërtur, Shkrel etj). Në Durrës kemi dëgjuar gjithashtu *kurr* (Bozanxhije).

Në Vlorë zanore të shkurtër *kurr*, ndërsa në Korçë zanore e mesme afër të gjatës me *ë* fundore shumë të reduktuar (*kurr-ë*).

Forma e gegërishtes veriore, dhe e toskërishtes me zanore të shkurtër besojmë të jetë më e re. Kjo bëhet edhe më e qartë po të kihen parasysh trajtat e autorëve të vjetër veriorë.<sup>38</sup>

## B. Kuantiteti i zanores së theksuar në rrokje të hapur

### I. Kuantiteti i zanores së theksuar në rrokje të hapur fundore

Format e trajtës së pashquar njëjës të disa emrave mashkullorë e femërorë me temë në zanore të theksuar.

§ 17. Këtu do të përfshijmë edhe ata emra, që kanë dalë në temë më *-n*, e cila më vonë, e ndodhur në fund të fjalës, ka rënë në disa forma rasore.

Zanorja e theksuar në rrokje fundore të hapur (sidomos tek emrat) në gegërishte del zakonisht e gjatë: *ka:*, *va:*, *dhe:*, *dhi:* (Çermënikë), *shpi:*, *dhi:*, *mi:*, *drû:*, *ka:*, *mulli:* (Elbasan), *shpi:*, *dhi:* (Durrës), *shpi:*, *raki:*, *buri:*, *dhi:*, *thmi:* (Krasniqe, Gash, Bytyç)<sup>39</sup>, *pe:*, *fre:*, *hi:*, *ka:*, *tra:* (Reç e Dardhë),<sup>40</sup> *fre:*, *hi:*, *hu:*, *pe:* (Luzni, Dibër), *ka:*, *tra:*, *dhe:* (Shkrel). Kështu edhe në të folme të tjera të Veriut.

Gjithashtu e gjatë del zanorja e këtij pozicioni edhe në të folmet toske të ekstremimit jugor: *tra:*, *pë:*, *dhi:*, *ka:*, *mulli* (Volë, Çamëri), *ka:*, *dhi:*, *ve:*, *hu:*, *mulli:*, *tru:*, *ulli:*, *sini:*, *dhe:*, *si:*, *bri:*, *hi:*, *hu:* (Kuç), *gja:*, *kala:*, *vëlla:*, *ve:*, *kerci:*, *kusi:*, *mi:*, *mulli:*, *dru:* (Bregdet i Poshtëm).<sup>41</sup>

Për shumë të folme gege (kryesisht të folmet e gegërishtes jugëperëndimore) është karakteristike të dalurit me mbaresë zero e vetës së dytë dhe e vetës së tretë njëjës për foljet me temë në zanore. Por në këto raste zakonisht zanorja ruan atë kuantitet që do të kishte në formën me mbaresë, dmth. kemi shkurtësi: *qënro*, *tako*, *largo* (II), *psho*, *tako*, *kthe* (III).

Disa folje të zgjedhimit të tretë në të folmen e Elbasanit dalin në njëjës, veta e tretë pa mbaresën *n* dhe zanoren e kanë të gjatë: (ai) *ha:*, *rri:*, *pi:* (gjatësia ekziston në të tria vetat). Në të folme të tjera gege dalin në vetën e dytë e të tretë njëjës, jo vetëm me mbaresë, por edhe pa mbaresë dhe gjithënjë me zanore të shkurtër: *ha*, *pi*, *rri*, duke dalluar kështu nga veta e parë që e ka zanoren fundore të temës të gjatë: *ha:*, *pi:*, *rri:* (Krasniqe, Gash e Bytyç).<sup>42</sup>

38) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XII*; «Studime Filologjike», 1, 1964, 88-89.

39) J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, «Buletin i Universitetit Shtet. të Tiranës», 4, 1963, 173.

40) B. Beci *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibërës*, «Studime Filologjike» 4, 1964, 138.

41) M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, Studime Filologjike, 1, 1964, 134.

42) J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, Bulet. i Univ. Shtet., 4, 1963, 185.

Në të folmet gege janë të gjata edhe zanoret e përfuara nga monoftongimi i një diftongu; e tillë është gjatësia në fjalët *gru:*, *kru:*, *ftu:*, *fillu:*, *kërku:*, *u liru:*; *kry:*, *ly:*, *ni:*, *shti:* etj.

Kjo gjatësi, për mendimin tonë, s'është gjë tjetër, veçse një lloj i veçantë gjatësie kompensatore.<sup>43</sup>

Mirëpo në të folmet e tjera të dialektit të Jugut, sidomos në toskërishten veriore, zanorja e theksuar në rrokje fundore të hapur rezulton e shkurtër: *shi*, *qiri*, *tra*, *mi*, *shpi* (Korçë), *shtëpi*, *dhe*, *sy*, *hi*, *qiri*, *tra*, *ka*, *dru*, *mulli*, *qersh* (Vlorë), *shi*, *ka*, *tra*, *mi* (Berat)<sup>44</sup>.

Në të folmet kalimtare në këtë pozicion fonetik përgjithësisht zanorja del e gjatë (Shpat, Dumre, Darësi e Peqinit, por ka raste kur dëgjohet e shkurtër: *fre*, *pe*, *li* (Rreth-Greth), por gjithashtu *hu:*, *tru:*, *tra:* (Rr.-Gr.). Në Vërçë (Shënepremte, Snosëm, Poroçan) gjatësia afron me gjatësinë e mesme: *fre.*, *ka.*, *sy.*, *ka.* (krahaso format e shumësit me zanore të shkurtër: *fre-fret*; *qe*, *sy-syt* etj.).

Gjatësia e zanores në këtë pozicion fonetik mund të jetë përfuar për shkaqe të ndryshme. Në radhë të parë, në shumë emra të këtij tipi ruhet edhe sot një gjatësi e hershme: *mi:*, *thi:*, *mulli:*, *e ve:*, *be:*, *va:*, *dru:*, *ka:*<sup>45</sup>. Përveç këtyre mund të përmenden edhe të tjerë emra, të cilët mund të kenë rënë ndonjë tingull fundor. Së dyti, edhe pozicioni fonetik i zanores ndikon në gjatësinë e saj. Dihet se një zanore e gjatë ka gjatësinë e saj të plotë, kur nuk pasohet nga bashkëtingëllore. Së treti, në shumë emra të këtij tipi mund të kemi gjatësi analogjike. Analogjia ka për bazë jo vetëm emrat, që ruajnë një gjatësi të hershme, por (në gegërishte) edhe emrat me zanore të gjatë të përfuar nga monoftongimi i një diftongu (*kru:*, *thu:*), emra ose folje me zanore të gjatë të përfuar si rezultat i një kontraksioni, ose me rënjen e një ose të disa tingujve (*ha:*, *je:*, *ke:*, *le:*, *nge:*, *vre:*, *re:* etj.). Pozicioni fonetik është po ai.

Por nuk na duket i drejtë mendimi se zanoret e gjata janë të lidhura me nazalitetin<sup>46</sup>. Ne kemi takuar edhe zanore të shkurtëra në rrokje të hapur ose të mbyllur, megjithëse janë hundore: *ullî*, *qi-u*, *hûj*. Nga ana tjetër, takohen rëndom edhe emra me zanore gojore të gjatë: *shi:*, *dhe:*, *dhi:* etj. Pra ne nuk mendojmë se të *hi:*, *bri:* zanoret janë të gjata se zanorja është hundore. Gjatësia këtu besoj të jetë gjatësi kompensatore në pasojë të rënjes së tingullit fundor *n* të temës. Siç e ka vënë re edhe G. Veigandi<sup>47</sup>, zanoret hundore fundore janë të shumtën të gjata. Kjo është e vërtetë, por hundorësia nuk është shkak i zgjatjes së zanores. Shkaku është rënja e bashkëtingëllores hundore të temës. Ne, përkundrazi, mendojmë se naza-

43) G. Weigandi në veprën e cituar, shënimi 1, e sheh gjatësinë e zanores *u:* te *gru:* si gjatësi natyrale, të vërtetë, ndërsa gjatësinë e zanores *a* te *pa:t* si gjatësi kompensatore, megjithëse ky gjuhëtar me të drejtë nuk kap ndonjë dallim midis këtyre dy gjatësive. Ne mendojmë se në të dy rastet kemi gjatësi kompensatore: njëra e përfuar nga reduktimi i diftongut *ue* në *u*; tjetra nga reduktimi i *ë* fundore.

44) Për Beratin të dhënat i kemi nga J. Gjinari.

45) E. Çabej, *Kuantiteti i zanorevet të theksuara të shqipes*, «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», 2, 1957, 209.

46) E. Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, 1963, 75.

47) G. Weigand, *Vepër e cituar*, 4.

liteti ose shkalla e tij varet gjer në një farë mase nga kuantiteti i zanores: zanoret e gjata kanë një nazalitet më të theksuar, nazalitet të një shkalle më të lartë.

## II. Kuantiteti i zanores së theksuar në rrokje të hapur jo fundore

§ 18. Shkallën e gjatësisë së mesme, zanoret e theksuara në gjuhën shqipe e kanë zakonisht në rrokje të hapur jofundore. Qoftë zanoret e gjata qoftë zanoret e shkurtëra, kur u shtohet një rrokje, bëhen gjatësi të mesme: *bu:k > bu.ka; ba:r > ba.ri; mullî > mullî.ni, shi: > shi.u, lejle:k > lejle.kët; shti: > shti.u*. Ky rregull vlen për të gjitha llojet e gjatësive që njohin të folmet e Veriut<sup>48</sup>. Gjithashtu edhe të shkurtërat kalojnë në të mesme: *lis > li.si, kap > ka.pa, i kuq > e ku.qe*.

Për këtë rrethanë tërheq vëmendjen Weigandi: «Shkurtësitë e fjalëve njërrrokëshe bëhen të gjatësisë së mesme, nëqoftëse ato rriten me një rrokje: *i kuq* (mashk.) e *ku.qe* (femërore), *bres > bre.zi, dy > i dy.ti, tym > ty.mi...*».

Më poshtë do të shohim më hollësisht disa forma fjalësh ku zanoret e theksuara janë të gjatësisë së mesme.

Përveç trajtës së shquar të emrave mashkullorë e femërorë në rasën emërore, dëgjohet e mesme zanorja edhe në format që vijojnë. Në disa të folme të dialektit të Jugut ë-ja e temës në format e trajtës së shquar njëjës të emrave femërorë me temë më ë në rasat gjindore, dhanore, rrjedhore, nuk është reduktuar, prandaj zanorja e theksuar dëgjohet e mesme: *lo.pës, di.tës, bo.tës, rru.gës, pa.tës*. E njëjta gjë vlen edhe për të folmet kalimtare (Dumre, Vërçë, Darsi e Peqinit, Shpat etj.); gjithashtu edhe për shumë të folme të gegërishtes jugore. Kështu p.sh.: *rru.gës* (Gr. Z.B.), *lo.pës* (Krr. Pl., Krr.B.), *pa.tës* (M.), *do.rës* (P.Pa., P.Q.), etj.

Emrat mashkullorë që sosin në temë me bashkëtingëllore në dialektin e Veriut e formojnë formën rasore të kallëzores në mënyra të ndryshme. Sipas kësaj, edhe zanorja e theksuar del e gjatë, e mesme ose e shkurtër. Por kur para mbaresës -n dalin zanoret epentetike *i, u* zanorja e theksuar është e gjatësisë së mesme: *le.shin, dre.qin, sqepa.rin* (Peqin, Elbasan, Grykë e Zaranikës, Martanesh, Shkodër). E njëjta gjë vihet re edhe në shumë të folme toske: *lakro.rin*, (Korçë), *lu.min, ke.cin, tra.rin* (Vlonë), *gja.kun* (Kuç) etj.

Në «rasën vendore» emrat femërorë, që sosin në temë me -ë, zakonisht e kanë zanoren e theksuar të mesme: *n'ka.mët, n'de.rët, me lo.pët* (Elbasan), *n'py.llët* (M.-pyllë-a), *me cu.cët* (L.F.), *n'go.jët* (P.M.), *m'rru.gët* (P., P.M.), *me bi.zët* (Sh.Sh.), *n'bu.kët* (Sh.), *m'tri.nët* (Sh.Q:) me *lopa.tët* (Sh.Q.), *m'rru.gët* (K. Kr.); po kështu edhe në të folme toske dhe kalimtare: *në do.rët* (Korçë), *n'go.jët* (Korçë), *n'ko.kët* (V.Sh.), *n'kaso.llët* (V.S.).

Gjatësi të mesme ka zanorja e theksuar kur ruhet mbaresa ë ose elementi fundor i temës me ë në shumësin e shquar të disa emrave

48) G. Weigand në veprën e cituar, f. 5 mendon të kundërtën se gjatësitë natyrale (echt) në shtesë mbesin të pandryshuara: «*he:r, he.ra, za:, za.ni*. Ne të *hera, zani* kemi konstatuar zanore të gjatësisë së mesme. Pastaj te *za*, për mendimin tonë, s'kemi gjatësi natyrale por gjatësi kompensatore.

mashkullorë e femërorë. Këtë formë e gjejmë më dendur në gegërishten jugore, sidomos në gegërishten jugë lindore dhe në disa të folme toske: *mulla.rët, gu.rët, kula.rët, dalla.pët, qerpi.kët, zhele.kët* (Elbasan), *sho.kët, oxha.kët* (Korçë), *dyshe.kët* (Vlorë); *lo.pët, bu.kët, pu.nët* (Elbasan), *de.gët, zo.rrët* (Vërçë), *lo.pët, qe.pët* (Korçë), *lo.pët, pu.nët* (Vlorë).

Gjatësi të mesme takojmë në format foljore të së kryerës së thjeshtë shumës në foljet me temë në bashkëtingëllore në rastet kur para mbaresave vetore del një ë epentetike: I *ka.pëm, ni.sëm, fo.lëm, du.lëm*; II *ka.pët, ni.sët, fo.lët*, III *ka.pën, ni.sën, fo.lën*. Trajta të tilla takohen p.sh. në Elbasan, në Reç-e Dardhë (Dibër, sipas B. Becit), e në mjaft të folme të tjera gege; paralelisht me trajta të tjera edhe në Kërrabë, Tiranë, Peqin, Dumre; gjithashtu edhe në disa të folme të Jugut.

Gjatësia e mesme vihet re edhe në format e pjesoreve të foljeve më bashkëtingëllore, sa herë që ato kanë një mbaresë që përbën një rrokje (mbaresë rrokësore); kjo konstatohet sidomos në të folmet toske; p.sh. në Gjirokastër-qytet, foljet me *l, ll, r*, që e ndryshojnë temën në të kryerën e thjeshtë, marrin mbaresën -ë: *da.lë, ma.rë, tje.rë*, ose në Bregdetin e Poshtëm kur marrin mbaresën -ur, sepse dëgjohen në përgjithësi të mesme zanoret e theksuara në rrokje të hapur, në mes të fjalës<sup>49</sup> etj. Më rrallë gjatësia e mesme në forma të tilla vihet re edhe në gegërishte. Kështu p.sh. në të folmen e Reç-e-Dardhës së Dibrës «Në raste ma të rralla foljet me temë më bashkëtingëllore marrin prapashtesën -un: *de.kun, fo.lun...* etj.»<sup>50</sup>. Në të folmet kalimtare vërehet e njëjta gjë: *fo.lun, ni.sun, la.gun* etj. (Darsi e Peqinit<sup>51</sup>). Po kështu në Shpat e Dumre.

*Format e trajtës së shquar të emrave mashkullorë, që sosin në temë me zanore të theksuar ose me dyzanorsh.*

§ 19. Format e trajtës së shquar të emrave mashkullorë, të cilët sosin në temë me dyzanorsh (*ua, ue*), që në shumë të folme gege është monoftonguar (*u:*), e kanë zanoren e theksuar në shkallën e gjatësisë së mesme ose të shkurtësisë. Ndryshe nga gjatësia e mesme e rastit të mësipërm, këtu mund të flitet edhe për gjatësi të diftongut, të elementit të parë të tij.

Gjatësi e mesme takohet rregullisht në Elbasan, Tiranë, Durrës (në të gjitha krahinat e këtyre rretheve), Martanesh, Lurë, në pjesën më të madhe të Çermenikës, në shumë të folme kalimtare, në Kuç e Çamëri. E ashtuquajtura «nyje e prapme shquese -i» dëgjohej si gjysëm vokale (*i*). Po japim disa shembuj për emrat e këtij tipi: *kro.i, prro.i, tho.i, fto.i, patko.i, ko.i, zgjo.i, spatho.i, vargo.i*. Për shumicën e të folmeve veriore gege nuk jemi të informuar, por ndërmjet tyre Shkodra, etj. në trajtën e shquar nxjerr nazalen *n-* para «nyjes», kështu

49) M. Totoni; 1) *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastrës*; «Stud. Filologjike», 1, 1966, 107; 2) *E folmja e bregdetit të Poshtëm*; «Stud. Filologjike»; 1, 1964, 134, 155.

50) B. Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, «Stud. Filologjike», 4, 1964, 158.

51) M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, «Stud. Filologjike» 4, 1965, 113.

që kemi gjithashtu gjatësi të mesme: *ftu*: > *fto.ni*, *vargu*: > *vargo.-ni*, *kru*: > *kro.ni*, *patku*: > *patko.ni*, *thu*: > *tho.ni*, *zgju*: > *zgjo.ni*.

Shkurtësi kemi takuar në emrat e këtij tipi në pak katunde të Çermënikës, që janë nën ndikimin e Mokrrës, e pikërisht në Zgosht e Letëm; në ish-katolikët e katundit Bizë të Ishmit, në të folmen kalimtare të Shpatit (Zavalinë, Gjinar, Trepsanisht), në Vlorë e në Korçë. Për të folmet e tjera nuk jemi të informuar. «Nyja e prapme» i dëgjohet afërsisht si bashkëtingëllorja *j* e fjalës *voj* dhe në këtë mënyrë trajta e shquar njëjës dhe shumësi i pashquar shumë përkohë plotësisht nga ana tingëllore; disa shembuj; *thoj*, *prroj*, *kroj*, *patkoj*, *ftoj* (Ç, Zg., Ç.L.); *thoj*, *ftoj*, *kroj*, *patkoj*, *prroj* (Zavalinë, Gjinar, Trepsanisht); *vargoj*, *zgjoj*, *ftoj*, *përroj*, *thoj* (Bizë e Ishmit); *ftoj*, *përroj*, *patkoj* (Korçë); *ftoj*, *përroj* (Vlorë). Në të gjitha këto kemi formën e trajtës së shquar (= *thoi*, *ftoi*, *kroi*). Në Vlorë e Korçë shkurtësia e këtij pozicioni afron pak me gjatësinë e mesme, por duket qartë dallimi nga gjatësia e mesme në të njëjtin tip formash të Elbasanit.

§ 20. Gjatësi e mesme dhe shkurtësi vihet re edhe në format e trajtës së shquar të emrave mashkullorë të tipit *ka-u*, që sosin në temë më zanore të theksuar gojore.

Gjatësia e mesme dhe shkurtësia e emrave të këtij tipi takohet pa asnjë përjashtim po në ato të folme ku takohet edhe gjatësia e mesme e shkurtësia e emrave të tipeve të mësipërm (*fto.i*, *ftoj*): *ka.u tra.u*, *mi.u*, *shi.u*, *bari.u*, *dhe.u*, *pasha.i* etj. (në të njëjtat vende ku takohet edhe *fto.i*); *kau*, *miu*, *vau*, *veriu*, *kadiu*, po kështu edhe *maj* -trajtë e shquar (Ç, Zg., Ç.L.); *kau*, *shiu* (Shpat); *miu*, *kau* (Korçë), *kau*, *shiu* (Vlorë; shkurtësia edhe këtu anon nga gjatësia e mesme). Varianti me zanore të shkurtër takohet në Shkrel: *kau*, *shiu*, *vllau*; në Shkodër: *kau*, *shiu*, *thiu*, *miu*, *vau*, *trau*, *thniu*; në Bizë (Ishëm): *shiu*, *kau*; *kau* (Poroçan i Zi, Vërçë). Në disa pika të banuara të Vërçës gjejmë rëndom trajtat me zanore të theksuar të shkurtër, por «nyja e prapme» *u* ka kaluar në *f*, duket nëpërmjet rrugës *u* > *w* > *v* > *f*, kryekëput nën ndikimin e shkurtësisë: *kaft*, *shift*, *mif* (Shënepremte), *mif*, *kaft*, *qirift* (Snosëm). I njëjti fenomen, siç dihet, konstatohet edhe në Devoll.<sup>52</sup> Ky fenomen shtrihet edhe në sistemin foljor (*kthef* etj.).

Duhet të theksojmë se në ato të folme gege ku gjejmë shkurtësi në trajtën e shquar (*kau*), në trajtën e pashquar kemi rregullisht gjatësi (*ka:*, *shi:*, *mi:*, *vlla:*). Përkundrazi, në të folmet toske ruhet shkurtësia e trajtës të pashquar edhe në të shquarën.

*Format e foljeve të zgjedhimit të tretë në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë.*

§ 21. Në këto forma foljore zanorja e theksuar është e gjatësisë së mesme dhe e shkallës së shkurtësisë. Shkallën e gjatësisë së mesme e takojmë pikë për pikë në atë trevë ku gjendet gjatësi e mesme në emrat e tipit *fto.i*, *ka.u*, *lufto.i*, *ço.i*, *kujto.i*, *puno.i*, *kalo.i*, *shterpo.i*, *pushto.i*, («nyja» i dëgjohet si gjysëm vokale *i* dmth. ka prirje të kalojë në bashkëtingëlloren *j*, por ka mbetur vetëm një variant i saj).

52) J. Gjinari, *Mbi të folmen e Devollit*, Bul. USHT, 4, 1960, 107.

Shkallën e shkurtësisë e takojmë pikë për pikë në atë trevë ku gjendet shkurtësi në emrat e tipit *ftoj, kau*. Mbaresa vetore *i* e ndodhur në pozicion të dobët fill pas një zanoreje të theksuar ka kaluar në bashkëtingëlloren *j* dhe duket krejtësisht si *j*-ja tek e tashmja (un) *punoj: (ai) filloj, gatoj, lshoj, fluroj, martoj, sajoj, rroj* (Ç. Zg.), *kallëz, shkoj, kaloj* (Ç.L.); *luftoj, shkoj, knoj, caktoj* (Sh. Z., por në këtë pikë edhe: *rroi, lçoi, pushoi*); *pushtoj, punoj, kërkoj, muloj*, (Sh. Gj); *çoj, kërkoj, shkoj* (Sh. Tr.); *shkoj, luftoj, çoj, gjikoj, liroj, shkoj, kërkoj, hetoj, diktoj, dëshiroj* (Shkodër). Në Vlorë e Korçë, si edhe tek emrat e tipit *ftoi, kau* dëgjohet një zanore e theksuar pak më e shkurtër se e mesmja e zakonshme. Në Bizë të Ishmit kemi shkurtësi: *punoj, kërkoj, fitoj*.

Po në këtë mënyrë ndahen të folmet e shqipes edhe për foljet, që dalin në temë më zanore të theksuar tjetër: *leu* (Ç.Zg.), *gjau*, (Ç.Zg.), *vrau* (Ç.L.), *zjeu* (Ç.L.), *dëftej* (Sh.Z.), *preu, thau*, (Sh.Gj). *preu, qau* (Shkodër). Krahaso format me gjatësi të mesme *le.u, gja.u, vra.u, dëfte.u, pre.u*, që gjejmë p.sh. në Elbasan.

Këto të dhëna e bëjnë tani mëse të qartë arësyen e transkribimit të vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë (njëlloj si vetën e parë të së tashmes) në shumë organe periodike të paraçlirimit, në veprat e disa rilindasve, të Mjedës, Nolit, Konicës etj., të cilët, në këtë pikë, në ortografinë e tyre ndjekin parimin thjesht fonetik, duke i shkruar këto forma ashtu siç i shqiptonin<sup>53</sup>.

## P Ë R F U N D I M E

1. Materialet e përshkruara më lart e vërtetojnë plotësisht konstatimin e shumë gjuhëtarëve se të folmet e dialektit të Veriut të gjuhës shqipe dhe disa të folme margjinale të toskërishtes si labërishtja, çamërishtja etj. njohin tri shkallë kuantiteti për zanoret e theksuara: gjatësi, gjatësi e mesme dhe shkurtësi.

Në të folmet e Jugut, me përjashtim të atyre që përmendëm më sipër, ekzistojnë dy shkallë kuantiteti për zanoret e theksuara e pikërisht: gjatësi e mesme dhe shkurtësi.

2. Dallime kuantitative të zanoreve të theksuara ekzistojnë jo vetëm midis dy dialekteve të shqipes (kryesisht sipas ekzistencës apo mungesës së shkallës së gjatësisë) por edhe midis grupeve të të folmeve e të folmeve të veçanta.

53) «Për Shqiptërinë / ditët e mira / paskëtaj vinë / shkoj erësira, / lum kush të rronjë, / ta shohë zonjë!» N. Frashëri, *Lulet e Verësë*, Bukuresht 1890, 59; «Shqipëria e qau dhe e vajtoj vjete me radhë», F. Noli «*Historia e Skënderbeut*», Boston, 1921, 269; Balsha III, me ato forca të paka që kishte, e dërmoj ushtrinë turke që u dërgua kundër tij... (Historia e Skënderbeut, f. 68); Kur e dëgjoj Sulltan Mehmeti tha: Një luan të tillë do mos lindë më dheu kurrë! dhe pastaj shtoj: «Tani Evropa dhe Asia janë të miat! Po aty, f. 269); Energjia morale dhe kuraja e tij janë ca më të çudiçime, dhe me këto Skënderbeu fitoj një vent në radhën e parë të kryetarëve të pavdekur. (Po aty, f. 281); Atje nisi, atje mbaroj, / Atje krisi, atje pushoj, — / Rrufe — shkab'e Malësisë; Në një shkëmb të Dragobisë. (F. Noli, *Albumi*, Boston, 1948, f. 49); Moli, tui këndue, lopën, / Tui pritun viçin prorë: / E tambli, bardh si borë, / Përmbrenda mjelcës ngufoj; Nd. Mjedja, *Juvenilja*; Vjenë, 1917, f. 33. Nd. Mjeda ka në këtë vepër, ndër të tjera edhe: rrënoj (f. 48), hinglloj, (f. 54); mbëloj (f. 64).

Kur i krahasojmë të folmet e gjuhës shqipe lidhur me kuantitetin e zanoreve të theksuara, del se ato ndryshojnë jo vetëm në zanoret e gjata, por edhe në zanoret e mesme. Pra, ekzistenca apo mungesa e zanoreve të shkallës së gjatësisë së mesme, në forma të caktuara fjalësh, është një tipar dallues i të folmeve ose grupeve të të folmeve brenda një dialekti. Nga kjo del se në gjuhën e sotme shqipe paraqesin interes dialektor jo vetëm shkalla e gjatësisë, por edhe ajo e gjatësisë së mesme. Në këtë pikë dallojnë jo vetëm të folmet e Veriut por edhe të folmet e Jugut.

3. Nga përhapja e shkallëve të ndryshme të kuantitetit, të gjatësisë, të gjatësisë së mesme, të shkurtësisë, që ne kemi rrokur në forma të njëjta fjalësh, rezulton një përfundim me rëndësi lidhur me perspektivën e kësaj dukurie (të kuantitetit), e pikërisht prirja drejt rrafshimit të shkallëve të gjatësisë e të gjatësisë së mesme jo vetëm në toskërishte, por edhe në gegërishte: zanoret e gjata dhe zanoret e gjatësisë së mesme në disa të folme të gegërishtes kanë filluar të kalojnë në zanore të shkurtëra. Megjithatë në gegërishte kjo prirje është akoma e dobët, procesi është akoma në fillim.

Prirja e rrafshimit të gjatësive ka filluar të pushtojë të gjitha tipet e gjatësisë së zanoreve, duke përfshirë, megjithëse në një masë më të kufizuar, edhe të ashtuquajturën «gjatësinë origjinale të hershme» (kujto *mjek*, *kut* e sidomos ato që kanë dalë në një pozicion të dobët, pa theks). Prirja e rrafshimit të gjatësisë së zanoreve shfaqet, në radhë të parë, në gjatësinë kompensatore të përfutur nga reduktimi gjer në shkallën zero i zanores ë fundore. Si përfundim i rrafshimit të gjatësisë, zanoret e gjata kalojnë përgjithësisht në zanore të shkurtëra dhe në ndonjë të folme edhe në zanore të mesme.

4. Për të shpjeguar rrafshimin e gjatësisë në gjuhën shqipe, ne mendojmë këto: gjatësia kompensatore, e, në radhë të parë, gjatësia në pasojë të rënjës së ë fundore, ka filluar të tronditet, për mendimin tonë, kryesisht në pasojë të analogjisë. Zanoret e theksuara të fjalëve, të cilave u ka rënë ë-ja fundore jo pak kohë përpara, tashmë ndodhen në rrokje të mbyllur e në këtë pozicion të ri fonetik ato perceptohen në ndërgjegjen e shqipfolësit sikurse zanoret e theksuara të shkurtëra të atyre fjalëve, që ndodhen në rrokje të mbyllur. Pra, kalohet nga *bu:k* në *buk* sipas *mik*, *gjak* etj.

Por gjatësia në gegërishte po ecën drejt rrafshimit edhe për faktin se opozicioni fonologjik i të gjatave ndaj të shkurtërave është mjaft i kufizuar; ky opozicion vihet re në një grup e forma fjalësh mjaft të kufizuara.

Së fundi, nuk duhet harruar edhe ndikimi i toskërishtes në zhdukjen e gjatësisë së gegërishtes.

5. Shumicën e zanoreve të theksuara të gjata e përbëjnë sot në gegërishte zanoret e gjata në pasojë të rënjës së ë fundore. Ky është pra tipi më i rëndomtë i kuantitetit kompensator; siç e kanë vënë re edhe Pekmezi, Weigandi etj., kjo gjatësi është tipike për gegërishten dhe është gjatësi e tipit të ri, sepse historikisht ajo është përfutur relativisht vonë.

Një tjetër lloj gjatësie kompensatore, mendojmë ne, është edhe gjatësia e zanoreve të përfutura nga monoftongimi i diftongjeve. Në këtë rast elementi i dytë i diftongut reduktohet, ndërsa i pari zgjatet.

*ue* > *u*: (*krue* > *kru:*, *ftuen* > *ftu:n*), *ie* > *i* (*diell* > *di:ll*), *ye* > *y* (*krye* > *kry:*). Edhe kjo lloj gjatësie është relativisht e re dhe karakteristike vetëm për gegërishten.

Së treti, gjatësi kompensatore është edhe gjatësia e disa zanoreve të theksuara të ndodhura sot në rrokje fundore të hapur e që përpara kanë pasur mbaruar me nazalen *n*, e cila shfaqet në forma të tjera të fjalës dhe që e ka bërë zanoren e theksuar edhe zanore hundore. *hû:* (*hûni*), *brî:* (*brîni*), *hî:* (*hîni*) etj.

Së fundi, gjatësi kompensatore për mendimin tonë, është edhe «gjatësia origjinare e herëshme», të cilën E. Çabej e trajtoi në mënyrë tërësore si të tillë i pari.

Ne pranojmë plotësisht mendimin e E. Çabejt se këto janë gjatësi të herëshme, që kanë ndodhur historikisht në një kohë relativisht mjaft të vjetër, duke qenë rezultat i shkrirjes së disa tingujve, rezultat i një kontraksioni, ose rezultat i rënjës së tingujve fundorë. Por, në fund të fundit, edhe këtu kemi zanore të gjatë në pasojë të reduktimit të pjesshëm të fjalës, reduktim ky që ka ndodhur pas zanores së theksuar, në mes ose në fund të fjalës. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në rastet e tjera të gjatësisë kompensatore. Dallimi midis tyre qëndron kryesisht në shtrirjen kohore: gjatësia kompensatore e herëshme është shumë më e vjetër se sa gjatësitë e tjera kompensatore.

Gjatësi e mirëfilltë origjinare e herëshme, për ne, do të ishte vetëm gjatësia që rrjedh nga një zanore e gjatë e periodës parashtiptare.

Në bazë të gjatësisë kompensatore të herëshme dhe në pasojë të ndonjë pozicioni fonetik të përshtatshëm për zgjatimin e zanores, në gjuhën shqipe, mund të thuhet se sot në disa fjalë kemi edhe gjatësi pozicionale (këtu duhen përfshirë dy grupe: a) disa zanore të pasuara nga bashkëtingëllorja *r* dhe b) disa zanore të theksuara në rrokje të hapur në fund të fjalës).

Duke u mbështetur në tipet e mësipërme të gjatësive që ekzistojnë në të folmet e shqipes ne duam të saktësojmë përfundimin e A. Dodit se «... gjatësia e tingujvet të shqipes së sotme është një përzierje e sistemit të vjetër konsequent të gjatësisë origjinare me tipin e ri të gjatësisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm. Kjo na bën që ta konsiderojmë këtë si një gjendje tranzitore»<sup>54</sup>.

Në të folmet e shqipes zanoret e theksuara kanë kryesisht:

1) gjatësi kompensatore të herëshme (të vjetër) për të cilën flet E. Çabej dhe 2) gjatësira kompensatore të vona (të reja) të tipeve: *bu:k*, *gru:*, *hû:*.

Pra këtu kemi kryesisht vazhdim të tipit të gjatësisë kompensatore të herëshme me kompensatore të re.

«Gjendjen tranzitore» të gjatësisë ne e pranojmë, por jo në kuptimin e A. Dodit; për ne gjatësia e zanoreve të theksuara në gjuhën e sotme shqipe është në gjendje tranzitore, por kjo duket pikërisht në prirjen e rrafshimit të saj, në faktin se ajo ka filluar të humbasë.

6. Gjatësia e zanoreve në të folmet e Veriut ka vlerë fonologjike. Opozicioni i të gjatave ndaj të shkurtërave, sipas të cilit diferen-

54) A. Dodi, Dispensë e cituar, 77.

cohen leksikisht e gramatikisht fjalët në dialektin e Veriut deri më sot ruhet mirë. Rastet kryesore janë këto:

1) Në diferencimin kuptimor të fjalëve të së njëjtës rrënjë të përftuar me konversion. Ja disa shembuj: *vesh*, *ve:sh-a*; *hedh*, *he:dh-a* (hedhjet e misrit...); *kullos*, *kullo:s-a*; *vras*, *vra:s-a* (Lurë); *herr*, *he:rr-a* (gjethe e duhanit e vogël që herret, P.M., në Ishëm *harr*, *ha:rr-a*); *pres*, *pre:s-a* (një prerje e hullive, Shijak, Z. Herr); *mun* (folje modale), *mu:n-a* (mundim, T.M.); *plas*, *pla:s-a* (Rr.K., Elbasan); *përtyp*, *përty:p-a* (Sh.Z.), *shem*, *she:m-a* (Peqin, Sh.Q.,M.), *lidh*, *li:dh-a* (lidhje, Durrës, Shijak); në disa nga këta shembuj duket qartë kalimi nga forma e vetës së I-rë njëjës e kohës së tashme të mënyrës dëftore në një emër të gjinisë femërore dhe përkatësisht zanorja e theksuar ka kaluar nga shkurtësi në gjatësi (*pres* — folje > > *pre:s* — emër, krahaso pjesoren *pre* të kësaj foljeje).

2) Në diferencimin kuptimor të fjalëve me rrënjë të ndryshme, të cilat afrojnë nga ana tingëllore pas ndonjë fenomeni fonetik që kanë pësuar: *grosh-i* (em. i gj. mashkullore), *gro:sh-a* (em. i gjinisë femërore); *pa:t* (vet. e II-të e të kryerës së thjeshtë sh. të foljes *shoh*) dhe *pat* (v. e III-të nj. e së kryerës së thjeshtë të foljes *kam*).

3) Në dallimin e formave të lidhores veta e I-rë dhe veta e III-të njëjës kohë e tashme; në krahasim me dy rastet e para ky rast është shumë më i kufizuar; p.sh. në Gjinar të Shpatit kemi dëgjuar: (un) *t'flas*, *t'bërtas*, *t'kap*; (ai) *t'fla:s*, *t'bërta:s*, *t'ka:p*.

4) Në dallimin e formave të njëjësit nga shumësi tek emrat me temë më bashkëtingëllore që e formojnë shumësin me mbaresën -ë *shok* - nj., *sho:k* - sh. *dyshek* - nj., *dyshe:k* - sh. Opozicioni i të shkurtërave ndaj të gjatave në njëjës dhe shumësin e emrave të këtij tipi ruhet mjaft mirë. Në disa të folme të gegërishtes veriore, te disa emra me temë më -r vihet re fenomeni i kundërt në opozicion (nj. *gu:r*, sh. *gur*), këtu, siç e ka vënë re edhe A. Dodi, tregues i shumësit është shkurtimi i zanores<sup>55</sup>.

Nga sa u tha gjer këtu lidhur me vlerën fonologjike të gjatësisë, nuk na duket i pranueshëm mendimi që pason: «Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithënjë e qartë vlera e gjatësisë. Po të kemi p.sh. dy subjekte nga populli, që ta shqiptojnë ata vetë shumësin me zanore të gjatë (*dyshek-dyshe:k*), njeri prej tyre vështirësohet për ta dalluar në shqiptimin e tjetrit njëjës apo shumësin. Kështu që, dhe atje ku ruhet diferencimi në sajë të traditës, vlera e tij fonologjike po zbehet. Në mjaft krahinë të gegërisë gjatësitë e tilla, që shërbejnë për diferencimin e kuptimit janë rrafshuar».<sup>56</sup>

Po të jenë bashkëbiseduesit, për të cilët flet autori, që të dy të zonës së Veriut, pavarësisht nga ç'krahinë janë, ata do ta marrin vesh njëri-tjetrin mjaft mirë duke diferencuar njëjës *dyshek* nga shumësi *dyshe:k*, sepse në të gjitha të folmet gege shumësi e njëjësi i emrave të këtij tipi diferencohen sot e kësaj dite mjaft mirë; pra në këtë rast konkret ne nuk shohim të zbehet vlera fonologjike e gjatësisë. Megjithatë një zbehje e vlerës fonologjike të gjatësisë ka filluar të vihet re p.sh. në dallimin e formave të pjesores nga veta e parë e njëjësit e kohës së tashme të mënyrës dëftore për foljet që dalin në

55) A. Dodi, Dispensë e cituar, 77.

56) A. Dodi, Dispensë e cituar, 76

temë me bashkëtingëllore (un *hudh*, kam *hudh*, por ruhet deri diku dallimi tek foljet më *r*, *rr*, *l*, *ll*: (un) *marr*, *ma:rr*).

Opozicioni i fonemave *a*:, *a*; *o*:, *o*; *e*:, *e*, *y*:, *y*, *i*:, *i* në të folmet e Veriut u bë i mundur vetëm me lindjen e gjatësisë së vonë kompensatore në pasojë të rënjes së ë fundore. Rënja e ë fundore bëri të mundur barazimin e shumë njësive tingëllore fjalësh e forma fjalësh, ndërsa gjatësia e re kompensatore, që përftoi zanorja e theksuar u bë element diferencues i këtyre fjalëve dhe formave.

7. Nga përshkrimi i hollësishëm i kuantitetit të zanoreve të theksuara rezultojnë edhe disa përfundime të tjera:

a) Fakti në se një e folme e toskërishtes ka zanore të gjatësisë së mesme apo zanore të shkurtër lidhet mjaft me shkallën e reduktimit të ë fundore: sa herë që ë-ja fundore ruhet ose reduktohet deri në një farë shkalle, atëhere zanorja e theksuar është e mesme; sa herë që ajo është reduktuar në shkallë zero kemi shumë herë zanore të shkurtër. Në të folmet toske reduktimi i plotë i ë fundore nuk sjell zgjatim të zanores së theksuar; ai nuk sjell as shkurtim të menjëhershëm të zanores së theksuar.

b) Gjatësia e mesme ndryshon në disa të folme, diku ajo është pak më e gjatë, duke iu afruar gjatësisë, e diku më e shkurtër.

c) Shkrimtarë të Rilindjes, si p.sh. N. Frashëri, dhe shkrimtarë të periudhës së Pavarësisë, si p.sh. Nd. Mjeda, F. Noli etj., e shkruajnë në veprat e tyre vetën e tretë të së kryerës së thjeshtë me *j* e jo me *i*, sepse ata ndjekin parimin fonetik, duke i shkruar këto forma siç i shqiptonin, ashtu siç i kishin në të folmet e tyre.

ç) Gjatësia nuk është tipar i pandashëm i formave të pjesoreve; në pjesoret e foljeve gjejmë sot në të folmet e Veriut jo vetëm gjatësi por edhe shkurtësi. Pra nuk është i drejtë mendimi se «pjesorja e ka gjithënjë zanoren të gjatë». <sup>57</sup>

d) Në asnjë rast gjatësia e zanoreve nuk është e lidhur me nazalitetin.

dh) Zanoret e theksuara të disa fjalëve të huazuara nga turqish-tja kanë kuantitet të ndryshëm në të folmet e shqipes.

e) Të gjitha llojet e gjatësive si dhe shkurtësia ruhen mirë në forma të caktuara fjalësh por jo në të gjitha format flektive. Siç e kanë thënë edhe të tjerë gjuhëtarë më parë, shkurtësitë dhe gjatësitë bëhen të gjatësisë së mesme kur u shtohet pas një rrokje.

ë) Gjatësia e mesme në rrokje të hapur jofundore dhe shkurtësia e zanoreve në rrokje të mbyllur janë shfaqje të kuantitetit pozicional në gjuhën shqipe.

8. Deri më sot kuantiteti i zanoreve të theksuara të gjuhës letrare kombëtare shqipe nuk është studjuar. Edhe A. Dodi në dispensën e tij trajton kuantitetin e tingujve të shqipes në përgjithësi, d.m.th. kuantitetin e zanoreve të theksuara të të dy dialekteve dhe jo kuantitetin e gjuhës letrare.

Ne kemi bërë disa hulumtime të pjesshme lidhur me kuantitetin e zanoreve të theksuara, duke ndjekur shqiptimin e folësve (spikërve) profesionalë e joprofesionalë të Radio Tiranës, shqiptimin e lektorëve e të referuesve në emisionet e Radio Tiranës, shqiptimin e disa personave të caktuar në mbledhje, në fjalime publike etj.

57) A. Dodi, Dispensë e cituar, 76.

Si përfundim, gjuha e sotme letrare ka në një përqindje të mirë rregulla të caktuara, tashme të fiksuara, lidhur me kuantitetin e zanoreve të theksuara.

Pohimi i A. Kostallarit se «gjuha letrare e sotme ka krijuar tashmë një sistem të vetin mbidialektor...»<sup>58</sup>, vërtetohet të paktën edhe me rregullat e kuantitetit të zanoreve të theksuara.

Po lejohem tani të bëj një paraqitje të pjesshme të kuantitetit të zanoreve të theksuara në gjuhën letrare. Vetëkuptohet, kjo temë kërkon një punim të hollësishëm e të plotë.

Në gjuhën letrare shqipe sot vihen re 3 shkallë të gjatësisë: gjatësi, gjatësi e mesme, shkurtësi.

1. Zanore të gjata kemi në këto raste: a) zanorja e theksuar fundore e mbyllur nga bashkëtingëllorja *r* në shumë raste dëgjohet e gjatë: *kalimta:r*, *jana:r*, *tipa:r*, *revolucionar:r*, *pjestar:r*, *fakto:r*, *shoqëro:r*, *verio:r*, *sasijo:r*, *popullo:r*, *bujqëso:r*, *shkenco:r*, *ndërkombëta:r*, *moneta:r*.

b) zanorja e theksuar fundore në shumë raste dëgjohet e gjatë: *krenari:.* *maqineri:.*, *çifteli:.*, *parti:.*, *histori:.*, *rëndësi:.*, *vendosmëri:.*, *mundësi:.*, *vazhdimësi:.*, *bujqësi:.*

Ka persona që shqiptojnë në këtë pozicion një zanore të gjatësisë së mesme: *dobi:.*, *ekonomi:.*, *fuqi:.*

c) Për sa i përket gjatësisë kompensatore të tipit të ri, duhen thënë këto gjëra. Sot në gjuhën letrare ë-ja fundore është reduktuar mjaft, madje ajo shpesh herë nuk dëgjohet fare.

Në folës të ndryshëm vihen re dy rezultate: rasti i parë, më i rëndomtë, është rasti kur ë-ja fundore është reduktuar gjer në zero dhe zanorja e theksuar është ose e gjatë, ose më e gjatë se e mesmja (ne do t'i japim si të gjata); rasti i dytë që vihet re sidomos në stilin e plotë të shqiptimit letrar është rasti ku ë-ja fundore dëgjohet mjaft e reduktuar dhe zanorja e theksuar pak më e gjatë se e mesme ose e gjatë). Një gjë karakteristike për gjuhën letrare pra është kjo se në rastin e parë, ndryshe nga ç'ndodh në shumë të folme të Jugut, gjatësia e mesme e zanores së theksuar nuk ka kaluar në shkurtësi, pas reduktimit të ë-së. Ndërmjet të tjerave, sot kemi paralelisht: *ra:dh*, *reze:rv*, *rru:g*, *ma:s*, *pro:n*, *fu:sh*, *ba:z*, *penge:s*, *kë:mb*, *shte:s*, *pje:s*, *ka:fsh*, *meto:d*, por edhe *ra:dh(ë)*, *rezerv(ë)*, *rru:g(ë)*, *ma:s(ë)*, *pro:n(ë)*, *fu:sh(ë)*, *ba:z(ë)*, *penge:s(ë)* etj.

Ndër këto variante paralele, i pari, takohet më shpesh, kryesisht nën ndikimin e dialektit verior dhe i përkrahur nga fakti se në shumë të folme të Jugut ë-ja fundore është reduktuar. Varianti i dytë, megjithëse më i rrallë, ka mundësi të ngrihet në normë, jo vetëm sepse norma e sotme drejtshqiptimore ndikohet mjaft nga norma drejtshkrimore, por edhe sepse ë-ja fundore, megjithëse e reduktuar, dëgjohet në disa të folme të tjera të Jugut. Koha do të tregojë se cili variant do të fitojë. Nëqoftëse do të ngrihet në normë varianti i dytë, të cilin parapëlqejmë edhe ne, kuantiteti në gjuhën letrare shqipe nuk do të ketë vlerë fonologjike: diferencimi i çifteve të fjalëve dhe formave të tilla si *pres* dhe *pre:s(ë)*, *dyshek* dhe *dyshe:k(ë)* do të bëhet jo vetëm sipas kuantitetit të shkallëve të ndryshme, por edhe sipas ë-së fundore të reduktuar që del vetëm në njerin element të opozicionit. Ne parapëlqejmë variantin e plotë (me zanore të gjatë ose

58) A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare*, S.F., 1970, N. 2. 27.

afër të gjatës e me ë fundore të reduktuar deri në një shkallë), sepse kështu ruhet struktura e plotë e fjalës edhe në variantin e folur të gjuhës letrare dhe se sistemi fonologjik i zanoreve nuk do të rritet me fonema të reja (zanore të gjata).

Dy variante takojmë shpesh edhe në këto raste: rasat e zhdrejta të emrave femërorë dalin sidomos në variantin: në gjirin e *shoqëri:s*, organet e *parti:s*, ndërmjet *bujqësi:s*, *fshatarësi:s* punonjëse, zhvillimin e *ekonomi:s*, zbatimi i *teknologji:s*, *demokraci:s*, të *veprimtari:s*, *pjellori:s*, të *bakti:s*, e *Shqipëri:s*.

Rastet me ë fundore mjaft të reduktuar janë fare të pakta: i *bujqësi:s(ë)*, *miqësi:s(ë)*.

Kjo gjendje vihet re edhe për formën e kallëzores: *besnikëri:n*, *përgjegjisi:n*, *mundësi:n* etj., si edhe për foljet të *vazhdo:im*, të *zhvillo:im*, të *thello:im*, të *lufto:im*, të *ekonomizo:im*; *mba:im*, *përcakto:in*, *ekzisto:in*, *lejo:in*, *përbë:in*, *pengo:in*, *thekso:in*, *syno:in*, por edhe të *vazhdo:im(ë)*, *lejo:in(ë)*, *ta pasuro:im(ë)*.

2) Zanore të gjatësisë së mesme kemi kur zanorja e theksuar është në rrokje të hapur jofundore: *gru.ri*, *li.gji*, *puni.mi*, *prodhi.mi*, *vendosmëri.a*; të tilla janë edhe zanoret e theksuara në fjalët e tipit *shi.u*, *ka.u*, *dituri.a*; si edhe në të kryerën e thjeshtë veta e tretë njëjës: *vazhdo.i*, *mëso.i*, *kërko.i*, *cilëso.i*.

3) Janë të shkurtëra, në radhë të parë, sikurse në të gjithë shqipën, zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur në fjalë si: *fshat*, *qytet*, *kyç*, *dyshek*, *vit*, *kujdes*, *problem*, *kontribut*, *rol*, *kusht*, *qëllim*, *personal*, *socialist*, *ekonomik*, *material*, *ideologjik*, *dallon*, *shkoj*, *kap*, *sjell* etj.

Po të ngrihet në normë drejtshqiptimore në gjuhën letrare varianti me ë fundore të reduktuar e me zanore të theksuar të gjatë, mund të nxjerrim këtë përfundim për kuantitetin: kuantiteti i zanoreve të theksuara të gjuhës letrare shqipe nuk paraqet vështirësitë e kuantitetit të zanoreve në dialekte. Kuantiteti i gjuhës letrare është dukuri e thjeshtë, jo aq e ndërlikuar, komplekse sa kuantiteti i zanoreve të të folmeve, sepse gjuha letrare përdor dyzanorshat në vend të zanoreve të gjata të përfutuara në monoftongim, pra nuk e ka si tipar të sajën gjatësinë kompensatore në pasojë të një monoftongimi, gjuha letrare përdor forma fjalësh pa asimilime, duke mos njohur trajtat arkaike të dialekteve, përdor forma gramatikore të plota (si pjesore me mbaresa, forma emërore e foljore me zanore epentetike etj.), ë në trup të fjalës në gjuhën letrare ruhet më mirë se në dialekte, më mirë sidomos në krahasim me të folmet e Veriut, dhe ajo që është më kryesorja, në gjuhën letrare gjatësia kompensatore është përfutur jo me rënjen e plotë të ë fundore, por vetëm në pasojë të reduktimit të pjesëshëm të saj, për shkak të së cilës gjatësia kompensatore e gjuhës letrare nuk ka fituar vlerë fonologjike.

9. Po të kihet parasysh ç'u tha më lart (shih sidomos § 6 të përfundimeve) kuantiteti dhe opozicionet e kuantitetit në dialektin e Veriut të gjuhës shqipe nuk duhen parë si ndikim sllav, si ç'mendon gabimisht *Vaclav Polak* në artikullin e tij *Albánci a Slované*, botuar në *Časopis pro moderni filologii—Ročník XXXIX*, 85-90.

## R é s u m é

LA QUANTITE DES VOYELLES TONIQUES  
DANS LES PARLERS DE L'ALBANAIS

L'article *La quantité de voyelles toniques dans les parlers de l'albanais* a été écrit par M. Çeliku en 1964. Dans la même année, l'auteur a communiqué une variante abrégée de cet article devant la session scientifique organisée par l'Institut d'Histoire et de Linguistique, à l'occasion du 20<sup>e</sup> anniversaire de la libération du pays.

Comme l'ont souligné aussi plusieurs autres linguistes, l'étude de la quantité des voyelles toniques dans les parlers de l'albanais offre des difficultés. L'étude de ce sujet est empêchée par plusieurs facteurs:

1<sup>o</sup> Entre les dialectes de l'albanais, entre des parlers singuliers et à l'intérieur même d'un seul parler existent des écarts quantitatifs assez grands des voyelles toniques dans les mêmes formes grammaticales, et aussi dans la même position phonétique.

2<sup>o</sup> La quantité des voyelles toniques de l'albanais d'aujourd'hui est un mélange de la quantité primitive avec le nouveau type de quantité, et précisément avec la quantité compensatoire.

3<sup>o</sup> Le mesurage exact de la quantité des voyelles est une tâche de la phonétique expérimentale, ce dont on ne fera pas de recours dans cette étude.

La quantité des voyelles de l'albanais a été traitée, jusqu'en 1957, fortuitement par des linguistes étrangers et albanais. Les constatations des divers linguistes ont fait connaître seulement les principaux aspects concernant la quantité. En 1957, E. Çabej fait paraître dans le «Bulletin de l'Université d'Etat de Tirana» l'article: *La quantité des voyelles toniques albanaïses*. Çabej, contrairement aux conjectures avancées jusque là, croit que dans la longueur et la brièveté d'une voyelle en albanais d'aujourd'hui n'a pas autant de poids son accentuation, et non plus la place qu'elle a à l'intérieur du mot, mais plutôt un critérium historique qui consiste à savoir si cette longueur est la continuation d'une longueur originale ancienne ou non.

M. Çeliku consacre son article à la description de la quantité des voyelles toniques en plusieurs parlers de l'albanais. Il a glané des matériaux dans 66 agglomérations de parlers différents de l'Albanie centrale. De même, une expédition organisée expressément en 1964 lui a permis de suivre ce phénomène également dans d'autres points: Korçe (ville), Vlorë (ville), Kurvelesh (les villages de Kuç et Nivice). Des matériaux sur la quantité l'auteur a glanés également à Lure (3 agglomérations) et pour le parler de la Çamërie (à Vole). L'auteur s'est tenu surtout à ses propres matériaux, car en suivant la quantité des voyelles de la même oreille, le résultat est absolument plus objectif, quoique l'on doive faire observer à ce propos que sans des mesurages de laboratoire de ce phénomène, il serait très difficile d'échapper à quelque dose de subjectivisme.

La matière de l'article se présente d'après la position phonétique de la voyelle tonique, quoique les résultats soient variés, parfois même contradictoires. Néanmoins, le matériel d'illustration est très abondant.

L'auteur fournit aussi les conclusions relatives:

1. Il existe des distinctions quantitatives des voyelles toniques non seulement entre les deux dialectes de l'albanais (le guègue et le tosqe) mais également entre des parlers singuliers. Dans la partie septentrionale du pays (en guègue) existent des voyelles longues, des voyelles de longueur moyenne et des voyelles brèves. Dans la partie méridionale (en tosqe), à l'exception des parlers de la Labë-

rie et de la Çamërie, existent des voyelles de longueur moyenne et des voyelles brèves. Ce partant, à l'heure que nous sommes, on peut affirmer que, à l'exclusion des parlars de la Labërie et de la Çamërie, l'existence ou l'absence de voyelles longues est un trait distinctif surtout des deux dialectes de l'albanais.

2. En différents parlars sont observées des distinctions quantitatives des voyelles toniques non seulement pour les voyelles longues mais également pour celles de longueur moyenne. De là, l'existence ou l'absence des voyelles du degré de longueur moyenne, dans des formes données de mots, constitue un trait distinctif des parlars ou des groupes de parlars à l'intérieur d'un dialecte. En conclusion, pour la langue albanaise actuelle, de l'intérêt dialectal offrent non seulement le degré de longueur, mais aussi celui de longueur moyenne. A cet effet, l'auteur Çeliku fournit non seulement des distinctions quantitatives entre les parlars du Nord, mais aussi entre des parlars du Sud.

3. Non seulement dans le dialecte tosqe, mais aussi dans celui guègue, quoique dans ce dernier dialecte d'une façon assez limitée, est observée la tendance d'aplatir la quantité: les voyelles longues et celles de longueur moyenne ont commencé à passer, dans quelques parlars des régions septentrionales du pays, en voyelles brèves.

4. La durée compensatoire, provoquée par la chute de l'*ë* final, dans les deux dialectes de l'albanais, a été aplatie (le Sud) ou bien s'ébranle déjà (le Nord), surtout comme conséquence de l'analogie. L'analogie a eu lieu sur la base des voyelles toniques brèves des mots, qui se trouvent en syllabe fermée ou entravée.

5. Une longueur compensatoire est également la durée produite à la suite de la monophthongaison des diphtongues (*krue* > *krū*, *ftuen* > *ftūn*, *diell* > *dīll*, etc.).

6. La durée des voyelles toniques est, dans plusieurs cas, longueur de position. On doit y distinguer, tout d'abord, la longueur des voyelles résultant comme conséquence de la consonne qui la suit; ainsi, la voyelle suivie par la consonne *r* est longue dans plusieurs mots (*gūr*, *mūr*, *ushtār*); au rang de la durée de position doit rentrer aussi la durée des voyelles toniques à la fin du mot (*shī*, *sī*, *trā*). Ces deux longueurs de position sont caractéristiques aussi à d'autres langues.

7. L'auteur admet aussi la longueur primitive ancienne, dont il se rapporte au travail en question de Çabej, mentionné plus haut. Tout de même, à cette occasion l'auteur croit que cette longueur ne soit autre, dans la plupart des cas, qu'une durée compensatrice qui a eu lieu à une époque très ancienne, provoquée par la réduction de timbres divers.

8. Diverses causes peuvent avoir influé dans la production des voyelles longues, causes naturellement enchevêtrées, mais qui ont produit la même conséquence.

9. L'auteur aboutit aussi à la conclusion que dans le dialecte du Nord les voyelles longues s'opposent aux brèves et que c'est de cette opposition qu'elles sont différenciées au double point de vue de la grammaire et du lexique. Cette opinion, l'auteur l'a lancée pour la première fois dans les travaux dialectologiques sur les parlars de la Dumré, Peqin et Kërrabe. Cette constatation a été rendue générale, par la suite, à tout le dialecte guègue par A. Dodi dans son manuel la *Phonétique de la langue albanaise*.

Les principaux cas où nécessite la valeur phonologique de la quantité sont les suivants: a) dans la différenciation sémantique des mots de la même racine, dont l'un est le produit de la conversion (*vësh* — verbe, *vësh* — nom; *hërr* — verbe, *hërr* — nom; *shëm* — verbe, *shëm* — nom); 2) dans la différenciation sémantique des mots à racines différentes (*grōsh*-*groshi*, *grōsh*-*grosha*; *pāt* — verbe, *pāt* — nom); c) dans la distinction des formes du conjonctif Ire et IIIe personnes du présent singulier. Ce phénomène accuse une extension très circonscrite (*t'flās*, *t'bërtās* —

*t'flās, t'bērtās*); d) dans la distinction des formes du singulier du pluriel dans les noms à thème en consonne, qui forment leur pluriel à l'aide de la désinence -*ë* (*shök* sing., *shök* pl.; *dyshëk* sing., *dyshëk*, pl.).

A propos de l'opposition de ces formes, l'auteur s'oppose à l'opinion que «dans la conscience des sujets-parlants n'est pas toujours évidente la valeur de la longueur» dans la distinction entre le pluriel et le singulier. Tout au contraire, l'auteur Çeliku soutient que dans tous les parlers guègues ces deux formes se font parfaitement distinguer à tout ce jour.

10. Çeliku aboutit, dans son travail, aussi à plusieurs autres conclusions:

a) Le fait à savoir si dans un parler du dialecte tosqe il y ait ou non des voyelles de longueur moyenne ou de celles de longueur brève se rattache, dans une mesure considérable, au degré de réduction de l'*ë* final: toutes les fois que l'*ë* final est conservé ou réduit dans une certaine mesure, alors la voyelle tonique est moyenne; toutes les fois qu'elle se trouve réduite à néant, alors on a la plupart du temps une voyelle brève;

b) La longueur moyenne diffère dans plusieurs parlers. Tantôt la durée est un peu plus longue, se rapprochant à la longueur moyenne, et tantôt cette durée est plus brève;

c) Naim Frashëri et d'autres hommes de lettres de la Renaissance, au même titre que Mjeda, Noli, et d'autres, écrivent la troisième personne du passé simple d'après le principe phonétique, enregistrant ces formes comme ils les prononçaient (*vajtoj, mbaroj, pushoj* pour *vajtoi, mbaroi, pushoi*);

d) Les voyelles toniques des mots empruntés au turc ont une quantité différente dans plusieurs parlers de l'albanais;

e) La longueur n'est nullement un trait indissoluble des formes des participes;

f) Sont exactes les constatations, désormais connues, que les parlers méridionaux tosqes de la Çamerie et de la Labërie ont le degré de longueur, et même, dans plusieurs cas, on y enregistre une longueur excessive. Dans ces parlers est coservée la longueur ancienne primaire même lorsque la voyelle résulte en syllabe ouverte au milieu du mot. Dans les parlers tosqes plus septentrionaux n'est pas conservée la longueur ancienne primaire. Au contraire, dans le dialecte guègue est parfaitement conservée la longueur ancienne primaire dans des formes données de mots, mais non point dans toutes les formes flectives.